

UDHËZIM
Nr. 24, datë 13.12.2022

**PËR FORMIMIN PROFESIONAL NË QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL
TË PERSONELIT HEKURUDHOR QË USHTRON FUNKSIONE SIGURIE,
KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR TESTIMIN, LICENCIMIN DHE
CERTIFIKIMIN E MAKINISTËVE¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 68, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë,

UDHËZON:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe objektivi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kushteve dhe i procedurave, programi i trajnimit profesional dhe organizimi i testimit për certifikimin dhe licencimin e makinistëve dhe kandidatëve për makinistë që operojnë në sistemin hekurudhor.

2. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve për ngritjen dhe njohjen e qendrave të formimit profesional, për njohjen e testuesve të kandidatëve për makinistë dhe për organizimin e provimeve të testimit.

3. Ky udhëzim specifikon detyrat për të cilat janë përgjegjës Autoriteti, makinistët dhe palët e tjera të interesuara në këtë sektor, veçanërisht sipërmarrjet hekurudhore, administruesit e infrastrukturës dhe qendrat e formimit profesional.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim zbatohet për makinistët e trenave që operojnë në sistemin hekurudhor, për një sipërmarrje hekurudhore që kërkon një certifikatë sigurie dhe një administrues infrastrukture që kërkon një autorizim sigurie.

2. Për qendrat e formimit profesional, që ofrojnë kurse trajnimi për makinistët dhe kandidatët për makinistë.

3. Për testuesit e makinistëve të autorizuar për të kontrolluar kompetencën e kandidatëve të makinistëve ose makinistëve.

4. Ky udhëzim nuk zbatohet për makinistët që operojnë në:

¹ Ky udhëzim është përafruar pjesërisht me:

- direktivën 2007/59/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 23 tetor 2007, “Mbi certifikimin e makinistëve që operojnë në lokomotiva dhe trena në sistemin hekurudhor në Komunitet”, OJ L 315, 3.12.2007;

- vendimin e Komisionit i 22 nëntorit 2011, “Mbi kriteret për njohjen e qendrave të trajnimit të përfshira në trajnimin e makinistëve, mbi kriteret për njohjen e testuesve të makinistëve dhe për kriteret për organizimin e provimeve, në përputhje me direktivën 2007/59/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”, 2011/765/BE; OJ L 314, 29.11.2011;

- vendimin e Komisionit i datës 29 tetor 2009, “Për miratimin e parametrave bazë për regjistrat e licencave dhe certifikatave plotësuese të parashikuara nga direktiva 2007/59/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”, 2010/17/BE; OJ L 8, 13.1.2010;

- rekomandimin e Komisionit i 22 nëntorit 2011, “Mbi procedurën për njohjen e qendrave të trajnimit dhe të testuesve të makinistëve, në përputhje me direktivën 2007/59/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”, 2011/766/BE; OJ L 314, 29.11.2011;

- rregulloren e Komisionit (BE) nr. 36/2010, të datës 3 dhjetor 2009, “Mbi modelet e komunitetit për licencat e makinistëve, certifikatat plotësuese, kopjet e certifikuara të certifikatave plotësuese dhe formularët e aplikimit për licencë makinisti, sipas direktivës 2007/59/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”, OJ L 13, 19.1.2010.

- a) tramvaje dhe sisteme të tjera hekurudhore të lehta;
- b) linja hekurudhore në pronësi private për përdorim nga administruesit e infrastrukturës për operimet e transportit të mallrave të tyre;
- c) linjat hekurudhore që janë përkohësisht të mbyllura për trafikun normal me qëllim të mirëmbajtjes, rinovimit ose përmirësimit të sistemit hekurudhor.

Neni 3 **Përkufizime**

Termat e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, kanë të njëjtin kuptim në këtë udhëzim. Përveç tyre, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Kërkues” do të thotë një ent ose një person i vetëm që kërkon njohje për të ofruar shërbime të ndryshme sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi;
- b) “Autoriteti” është “Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore”, i përcaktuar në nenin 69 të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” dhe i ngritur sipas ligjit nr. 88/2021, datë 1.7.2021, “Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore”;
- c) “Njohje” do të thotë një deklaratë zyrtare mbi kompetencën e një personi ose të një subjekti për të kryer detyra për të cilat kërkon, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi;
- d) “Provim” do të thotë një proces që organizohet për të kontrolluar kompetencën e një makinisti ose kandidati për makinist dhe zhvillohet me shkrim, me gojë dhe në praktikë;
- e) “Punonjës të tjerë të trenit që kryejnë detyra për sigurinë” nënkupton personelin në tren, i cili nuk është drejtues i trenit, por që ndihmon për të garantuar sigurinë e trenit, të pasagjerëve dhe mallrave që transportohen;
- f) “Testues” është një person që administron dhe vlerëson provimet për të testuar njohuritë dhe aftësitë e makinistëve apo të personave të tjerë ndihmës dhe të sigurisë.
- g) “Trajnues” nënkupton një person me aftësi dhe kompetencë përkatëse për të përgatitur, organizuar dhe zhvilluar kurse trajnimi;

KREU II QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL

Neni 4 **Pavarësia dhe paanshmëria**

Qendrat e formimit profesional ofrojnë kurse trajnimi në mënyrë të paanshme për të gjithë pjesëmarrësit dhe në mënyrë të pavarur nga interesat e kompanisë që zotëron qendrën.

Qendrat e formimit profesional zbatojnë të njëjtat rregulla për personat e punësuar nga shoqëria zotëruese e qendrës së trajnimit si dhe për personat e tjerë.

Neni 5 **Kushtet bazë për regjistrim**

1. Kërkuesi për qendër formimi profesional duhet të vërtetojë kompetencën teknike, të ketë staf të certifikuar nga Agjencia Evropiane e Hekurudhave, më poshtë “Agjencia”, pajisje dhe mjedis të përshtatshëm për trajnim, me qëllim përgatitjen e makinistëve dhe kërkuesve të tjerë për provimet, për të marrë ose për të mbajtur licenca dhe certifikata, në përputhje me këtë udhëzim.

2. Në veçanti, kërkuesit për qendër formimi profesional duhet:

- a) që trajnuesit të kenë kualifikimet dhe përvojën e duhur për të ofruar trajnime sipas kërkesave të këtij udhëzimi;
- b) të ketë personelin e nevojshëm, objektet, pajisjet dhe mjedisin e duhur për trajnimin e ofruar dhe numrin e vlerësuar të trajnuarve;

c) që trajnimi praktik të kryhet nga trajnues që mbajnë licencë të vlefshme të makinistit të trenit dhe një certifikatë të vlefshme që mbulon linjën dhe mjetet hekurudhore të praktikës, dhe që kanë përvojë profesionale në drejtimin e trenave me kohëzgjatje minimale trevjeçare. Kur trajnuesi nuk ka certifikatë të vlefshme për linjën dhe për mjetet hekurudhore përkatëse, duhet të jetë i pranishëm në trajnim një makinist që ka certifikatën për atë linjë hekurudhore, në përputhje me nenin 14, pika 2, shkronja “e”, më poshtë.

d) të sigurojnë organizimin dhe kohëzgjatjen e nevojshme të kurseve të trajnimit, për realizimin e programeve të trajnimit;

e) të sigurojnë sisteme për regjistrimin e aktiviteteve të trajnimit, duke përfshirë informacionin për pjesëmarrësit, trajnuesit dhe numrin e kërkuesve;

f) të kenë një sistem të menaxhimit të cilësisë për të monitoruar që trajnimi i ofruar plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë udhëzim;

g) të sigurojnë trajnime të vazhdueshme dhe masa për të mbajtur të përditësuara aftësitë profesionale për trajnuesit;

h) të demonstrojnë procedura për të mbajtur të përditësuara metodat, mjetet dhe pajisjet e trajnimit, duke përfshirë literaturën e trajnimit, softuerin e trajnimit, dokumentet e ofruara nga administratori i infrastrukturës, rregulloret, sinjalet ose sistemet e sigurisë etj.

3. Kërkuesit për trajnim për procedurat e funksionimit hekurudhor dhe të sigurisë, duhet të paraqesin kërkesën e tyre pranë Autoritetit.

Neni 6

Qendrat e formimit profesional që i përkasin një sipërmarrësi hekurudhor ose një administratori infrastrukture

1. Një sipërmarrës hekurudhor ose një administrator infrastrukture mund të kërkojë dhe të ofrojë trajnime profesionale ekskluzivisht për stafin e kompanisë së tij, por që përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 5 të këtij udhëzimi.

2. Në këtë rast, deklarata e njohjes shënohet në certifikatën përkatëse të sigurisë ose autorizimin e sigurisë.

3. Organizimi i punës dhe vlerësimi i kërkesës të përmendur në paragrafin 1, bëhet për të parandaluar çdo konflikt interesi.

Neni 7

Linja e re hekurudhore dhe mjetet e reja hekurudhore

1. Në lidhje me linjat e reja hekurudhore ose mjetet hekurudhore që kërkohet të futen për herë të parë në qarkullim, qendra e trajnimit organizon trajnime praktike në përjashtim të nenit 5, pika 2, shkronja “c”, por ndalohet në rastin kur nuk ka asnjë trajnues që mban certifikatë që mbulon linjën e re.

2. Trajnuesi duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e tjera të nenit 5, në lidhje me licencën dhe certifikatën, siç parashikohet në nenet 19 dhe 21 të këtij udhëzimi dhe periudhën e kërkuar të praktikës profesionale.

Neni 8

Kërkesa për njohjen, rinovimin ose ndryshimin e një qendre formimi profesional

1. Qendrat e formimit profesional mund të krijohen nga administruesit e infrastrukturës, sipërmarrjet hekurudhore, subjektet publike apo private.

2. Për njohjen, rinovimin ose ndryshimet që kërkohen, qendra e formimit profesional paraqet një kërkesë të specifikuar me shkrim tek Autoriteti.

3. Kur qendra ka administratorë ose ortakë më shumë se një person juridik, secili prej personave juridikë kërkon veçmas për njohje.

4. Kërkesat përfshijnë dokumente që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim dhe specifikojnë detyrat e trajnimit që i përkasin fushave të kompetencës, si vijon:

- a) njohuri të përgjithshme profesionale, në përputhje me aneksin IV;
- b) njohuri profesionale, në lidhje me mjetet hekurudhore, në përputhje me aneksin V;
- c) njohuri profesionale për infrastrukturën, në përputhje me aneksin VI;
- d) njohuri gjuhësore, në përputhje me aneksin VI.

Neni 9

Lëshimi i deklaratës së njohjes së një qendre formimi profesional

1. Autoriteti lëshon deklaratë njohjeje jo më vonë se 2 muaj pas marrjes së të gjitha dokumenteve të nevojshme të kërkuara.

2. Autoriteti merr vendimin e tij për kërkesat që i janë bërë, bazuar në aftësinë e kërkuarit për të demonstruar se si sigurohet pavarësia, kompetenca dhe paanësia.

3. Deklarata e njohjes përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe adresën e Autoritetit;
- b) emrin dhe adresën e qendrës së trajnimit;
- c) detyrat e trajnimit, për të cilat qendra e formimi profesional ka të drejtë të ofrojë, në përputhje me nenin 8 pika 4;
- d) numrin e identifikimit të qendrës të dhënë, në përputhje me regjistrin sipas nenit 28;
- e) datën e skadimit të deklaratës së njohjes.

Neni 10

Vlefshmëria, ndryshimi, rinovimi i deklaratës së njohjes së një qendre formimi profesional

1. Deklarata e njohjes së qendrës së formimit profesional është e vlefshme për 5 vjet.

2. Qendra e trajnimit që zotëron deklaratë të vlefshme njohjeje, mund të kërkojë në çdo kohë për të zgjeruar fushëveprimin e detyrave të trajnimit. Duke u bazuar në dokumentet e duhura plotësuese të ofruara nga kërkuari, lëshohet një deklaratë njohjeje e ndryshuar por pa ndryshuar datën e vlefshmërisë.

3. Kur kërkesat për një ose më shumë detyra trajnimi të specifikuar në deklaratën e njohjes nuk përmbushen më, qendra e njohur e trajnimit duhet të ndërpresë menjëherë trajnimin, në lidhje me detyrat në fjalë dhe të informojë me shkrim Autoritetin, i cili vlerëson informacionin dhe lëshon një deklaratë të ndryshuar të njohjes, por pa ndryshuar datën e vlefshmërisë.

4. Deklarata e njohjes rinovohet me kërkesë të qendrës së formimit profesional, duke dorëzuar të dhënat e aktiviteteve të trajnimit të kryera gjatë dy viteve të mëparshme dhe lëshohet në të njëjtat kushte si deklarata fillestare e njohjes. Kur periudha e mëparshme e vlefshmërisë është shkurtuar në më pak se 2 vjet, në përputhje me pikën 1, duhet të dorëzohen të dhënat për të gjithë periudhën.

Neni 11

Pezullimi dhe heqja e njohjes

1. Kur aktivitetet e vlerësimit ose të mbikëqyrjes të kryera nga Autoriteti, në përputhje me nenin 45, ofrojnë dëshmi, se një qendër formimi profesional nuk përmbush kërkesat për njohje, Autoriteti heq ose pezullon deklaratën përkatëse të njohjes.

2. Kur Autoriteti konstaton se qendra e trajnimit nuk i plotëson më kërkesat për njohje, Autoriteti heq ose pezullon deklaratën e njohjes.

Neni 12

Procedura e ankimit

1. Autoriteti informon menjëherë qendrën e formimit profesional me shkrim, në lidhje me kërkesat që nuk plotësohen më, mbi bazën e të cilave janë marrë vendimet e pezullimit ose heqjes së deklaratës së njohjes.

2. Përpara se pezullimi ose heqja të hyjë në fuqi Autoriteti, siguron një periudhë njoftimi brenda së cilës qendra e trajnimit mund të përshtatë praktikat e saj në mënyrë që të përmbushë kërkesat për njohje. Nga ana tjetër, Autoriteti informon qendrën e trajnimit për procedurën e apelimit të ngritur për lejimin e rishikimin të vendimit.

Neni 13

Qendrat e formimit profesional që ofrojnë trajnime gjuhësore

1. Për njohjen e qendrës së formimit profesional që ofron trajnime gjuhësore, ndiqen procedurat njëloj me praktikën kombëtare, në lidhje me certifikimin e qendrave të trajnimit gjuhësor.

2. Në lidhje me trajnimin mbi komunikimin dhe terminologjinë specifike për operimin hekurudhor dhe procedurat e sigurisë, kërkohet njohja pranë autoritetit, në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

KREU III

CERTIFIKIMI I MAKINISTËVE

Neni 14

Modeli i certifikimit të makinistëve

1. Për drejtimin e trenit makinisti duhet të ketë dokumentet e mëposhtme:

a) një licencë që tregon se makinisti plotëson kushtet minimale për sa u përket kërkesave mjekësore, arsimit bazë dhe aftësive të përgjithshme profesionale. Në licencë identifikohet makinisti dhe Autoriteti lëshues dhe shënohet kohëzgjatja e vlefshmërisë së saj. Licenca do të jetë në përputhje me kërkesat e aneksit I;

b) një ose më shumë certifikata që tregojnë linjat në të cilat mbajtësi është i autorizuar të drejtojë dhe që tregojnë mjetet hekurudhore, të cilat mbajtësi është i autorizuar të drejtojë. Çdo certifikatë duhet të përputhet me kërkesat e aneksit I.

2. Kërkesa për të mbajtur një certifikatë për një pjesë të caktuar të linjave nuk do të zbatohet në rastet e jashtëzakonshme të renditura më poshtë, me kusht që një makinist tjetër i trenit, i cili zotëron një certifikatë të vlefshme për linjat në fjalë, të ulet pranë makinistit të mjetit hekurudhor gjatë drejtimit:

a) kur nevojitet ose ka një kërkesë nga shërbimi hekurudhor për devijimin e trenave ose mirëmbajtjen e binarëve, siç përcaktohet nga administratori i infrastrukturës;

b) për shërbime të jashtëzakonshme, të njëhershme që përdorin trena historikë;

c) për shërbime të jashtëzakonshme të transportit të mallrave, me kusht që administratori i infrastrukturës të jetë dakord;

d) për dorëzimin ose demonstrimin e një treni ose lokomotive të re;

e) për qëllime të trajnimit dhe provimit të makinistëve.

Përdorimi i kësaj mundësie është vendim i sipërmarrjes hekurudhore dhe nuk mund të imponohet nga administratori përkatës i infrastrukturës ose nga Autoriteti.

Sa herë që përdoret një makinist shtesë, siç parashikohet më sipër, administratori i infrastrukturës duhet të informohet paraprakisht.

3. Certifikata autorizon drejtimin në një ose më shumë nga kategoritë e mëposhtme:

a) kategoria A: lokomotivat manovruese, trenat e punës, mjetet hekurudhore të mirëmbajtjes dhe të gjitha lokomotivat e tjera kur ato përdoren për manovrim;

b) kategoria B: transport udhëtarësh dhe mallrash.

Një certifikatë mund të përmbajë një autorizim për të gjitha kategoritë.

4. Modeli për licencën, certifikatën dhe kopjen e vërtetuar të certifikatës, si dhe masat kundër falsifikimit do të jetë sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

Neni 15

Masat kundër mashtrimit

Autoriteti dhe organet lëshuese, administratorët e hekurudhës dhe sipërmarrësit hekurudhorë, marrin të gjitha masat e nevojshme për të shmangur rreziqet e falsifikimit të licencave, certifikatave dhe regjistrave të parashikuar në nenin 28.

Neni 16

Pronësia, gjuha dhe organet lëshuese

1. Licenca është në pronësi të mbajtësit të saj dhe lëshohet nga Autoriteti në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

2. Certifikata lëshohet nga sipërmarrja hekurudhore ose administratori i infrastrukturës që punëson ose kontraktin makinistin. Certifikata është në pronësi të sipërmarrjes ose administratorit që e lëshon atë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

Makinistët kanë të drejtë të marrin një kopje të vërtetuar të certifikatës.

Neni 17

Vlefshmëria gjeografike

1. Një licencë do të jetë e vlefshme në të gjithë territorin e vendit dhe në vendet kufitare sipas marrëveshjeve.

2. Një certifikatë është e vlefshme vetëm për ato infrastruktura dhe mjete lëvizëse të identifikuar në të.

KREU IV

KUSHTET DHE PROCEDURA PËR MARRJEN E LICENCËS DHE CERTIFIKATËS

Neni 18

Kushtet për pajisjen me licencë

Për të marrë një licencë makinisti, kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat minimale, si vijon:

- a) mosha minimale duhet të jetë të paktën 22 vjeç;
- b) duhet të kenë përfunduar me sukses të paktën arsimin tetëvjeçar deri në vitin 2020 dhe më pas arsimin nëntëvjeçar;
- c) të japin konfirmimin mjekoligjor të aftësive fizike dhe psikologjike, duke treguar të paktën kriteret e vendosura në seksionet 1.1, 1.2, 1.3, 2.1 dhe 2.2 të aneksit II.
- d) të kenë demonstruar kompetencën e tyre të përgjithshme profesionale, duke dhënë një provim që mbulon të paktën lëndët e përgjithshme të renditura në aneksin IV.

Neni 19

Procedura e marrjes së licencës

1. Autoriteti publikon në faqen zyrtare dhe ambientet e institucionit procedurën që duhet ndjekur për marrjen e licencës.

2. Të gjitha kërkimet për licencë duhet të depozitohen pranë Autoritetit nga makinisti kandidat ose çdo subjekt në emër të tij.

3. Kërkesat e paraqitura pranë Autoritetit mund të jenë për dhënien e një licence të re, përditësimin e të dhënave të licencës, rinovimin ose dublikatën.

4. Autoriteti lëshon licencën sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se një muaj pas marrjes së të gjitha dokumenteve të nevojshme.
5. Licenca është e vlefshme për 10 vjet.
6. Licenca lëshohet në një original të vetëm ose kopje të vërtetuar vetëm nga Autoriteti.

Neni 20

Kushtet për pajisjen me certifikatë

Për të marrë një certifikatë, kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat minimale si vijon:

- a) të zotërojë njohuri gjuhësore për infrastrukturën për të cilën po kërkohet certifikata;
- b) të kenë kaluar një provim, duke testuar njohuritë dhe kompetencën e tyre profesionale, në lidhje me mjetet hekurudhore për të cilat kërkohet certifikata. Ky provim do të mbulojë të paktën lëndët e përgjithshme të renditura në aneksin V;
- c) të kenë kaluar një provim, duke testuar njohuritë dhe kompetencën e tyre profesionale në lidhje me infrastrukturën për të cilën kërkohet certifikata. Ky provim do të mbulojë të paktën lëndët e përgjithshme të renditura në aneksin VI;
- d) të trajnohen nga sipërmarrja hekurudhore ose administratori i infrastrukturës, në lidhje me sistemin e saj të menaxhimit të sigurisë të parashikuar nga neni 64, pika 2, shkronja “g”, e ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 21

Procedura e marrjes së certifikatës

1. Çdo sipërmarrje hekurudhore dhe administrator i infrastrukturës publikon procedurat e veta për lëshimin dhe përditësimin e certifikatave, në përputhje me këtë udhëzim, si pjesë e sistemit të saj të menaxhimit të sigurisë, si dhe procedurat e apelimit që lejojnë makinistët të kërkojnë rishikimin e një vendimi, në lidhje me këtë çështje, përditësimin, pezullimin ose tërheqjen e një certifikate.
2. Në rast mosmarrëveshjeje, palët mund të ankohen pranë Autoritetit dhe në rast mospranimi vendimi, pranë Autoritetit Rregullator Hekurudhor.
3. Sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës përditësojnë, brenda një periudhe njëmuajore, një certifikatë sa herë që mbajtësi i certifikatës ka marrë autorizime shtesë, në lidhje me mjetet hekurudhore ose infrastrukturën.

Neni 22

Kontrolle periodike

1. Për ruajtjen e vlefshmërisë së licencës, mbajtësi i saj u nënshtrohet kontrolleve periodike në lidhje me kërkesat mjekësore, duke paraqitur një raport mjekoligjor dhe psikologjik, sipas afateve, në përputhje me aneksin II dhe njohuritë e përgjithshme profesionale sipas nenit 29, pika 8. Gjatë rinovimit të licencës, Autoriteti verifikon në regjistrin e parashikuar në nenin 28, pika 1, shkronja “a”, nëse makinisti ka plotësuar kërkesat më sipër.
2. Në mënyrë që një certifikatë të mbetet e vlefshme, mbajtësi i saj duhet t’u nënshtrohet kontrolleve periodike, në lidhje me kërkesat e përmendura në nenin 20. Frekuenca e këtyre kontrolleve do të përcaktohet nga sipërmarrja hekurudhore ose administratori i infrastrukturës që punëson ose kontraktin makinistin, në përputhje me sistemin e tij të menaxhimit të sigurisë dhe respekton frekuencat minimale të përcaktuara në aneksin VII. Për secilin prej këtyre kontrolleve, organi lëshues konfirmon me një shënim në certifikatë dhe në regjistrin e licencave që drejtuesi i mjetit ka plotësuar kërkesat e mësipërme.
3. Kur një kontroll periodik mungon ose jep rezultat negativ, zbatohet procedura e parashikuar në nenin 24.

Neni 23

Ndërprerja e punësimit të makinistit

1. Kur një makinist ndërpret marrëdhëniet e punës me një sipërmarrje hekurudhore ose një administrator infrastrukture, ai informon pa vonesë Autoritetin.

2. Në këtë rast licenca mbetet e vlefshme, me kusht që përcaktimet në nenin 22, pika 1, të mbeten të përmbushura.

3. Certifikata bëhet e pavlefshme, kur mbajtësi i saj ndërpret marrëdhëniet e punës si makinist. Me kërkesë të tij, mbajtësi merr një kopje të vërtetuar të saj dhe të të gjitha dokumenteve që tregojnë trajnimin, kualifikimet, përvojën dhe kompetencat e tij profesionale dhe që vlerësohen para marrjes së certifikatës.

Neni 24

Monitorimi i makinistëve nga sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës

1. Sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës sigurojnë nëpërmjet monitorimeve që licencat dhe certifikatat e makinistëve që ata punësojnë, të jenë të vlefshme.

2. Nëse makinisti paraqet probleme shëndetësore dhe ndiehet i paaftë për punë, ai duhet të informojë menjëherë sipërmarrjen hekurudhore ose administratorin e infrastrukturës, cilado që është e përshtatshme.

3. Sipërmarrja hekurudhore ose administratori i infrastrukturës duhet të marrë menjëherë veprimet e nevojshme, duke përfshirë ekzaminimin e përshtatshëm në seksionin 3.1, të aneksit II, deri në heqjen e certifikatës dhe përditësimin e regjistrit të certifikatave. Për më tepër, të sigurojnë që në asnjë moment gjatë shërbimit të tyre makinistët të mos jenë nën ndikimin e ndonjë substance që ka të ngjarë të ndikojë në përqendrimin, vëmendjen ose sjelljen e tyre.

4. Sipërmarrjet hekurudhore ose administratorët e infrastrukturës të informojnë pa vonesë Autoritetin për çdo rast të paaftësisë për punë më shumë se tre muaj.

KREU V

DETYRAT DHE VENDIMET E AUTORITETIT

Neni 25

Detyrat e Autoritetit

1. Autoriteti, krahas detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, dhe në ligjin nr. 88/2021, datë 1.7.2021, “Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore”, përmbush detyrat e mëposhtme në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese:

a) lëshimin dhe përditësimin e licencave dhe sigurimin e kopjeve të vërtetuara, siç parashikohet në nenet 16 dhe 19;

b) sigurimin e kontroleve periodike siç parashikohet në nenin 22, pika 1;

c) pezullimin dhe heqjen e licencave dhe njoftimin e organit lëshues për kërkesat e arsyetuara për pezullimin e certifikatave, siç parashikohet në nenin 45;

d) mbajtjen, publikimin dhe përditësimin e regjistrit të licencave, siç parashikohet në nenet 22, pika 1, dhe 28, pika 1, dhe regjistrin të personave dhe organeve që janë akredituar sipas këtij udhëzimi;

e) monitorimin e procesit të certifikimit të makinistëve, siç parashikohet në nenin 24;

f) kryerjen e inspektimeve siç parashikohet në nenin 45;

g) vendosjen dhe kontrollin e kriterëve kombëtare për testuesit, siç parashikohet në nenin 32.

Gjatë përgatitjes së licencave, Autoriteti u përgjigjet në kohën sa më të shpejtë kërkesave dhe paraqet çdo kërkesë për informacion shtesë pa vonesë.

2. Autoriteti në përgjithësi nuk u delegon palëve të treta detyrat e përmendura në shkronjat “c”, “e” dhe “g”, të paragrafit 1. Në rast se ndodh, delegimi bëhet në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe nuk shkakton konflikt interesash.

3. Në rastin kur Autoriteti delegon ose kontraktin detyrat e përmendura në shkronjat “a” ose “b”, të paragrafit 1, një sipërmarrjeje hekurudhore, ajo duhet të përmbushë të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) sipërmarrja hekurudhore lëshon licenca vetëm për makinistët e saj;

b) sipërmarrja hekurudhore nuk gëzon ekskluzivitet në territorin në fjalë për asnjë nga detyrat e deleguara ose të kontraktuara.

4. Në rastin kur Autoriteti delegon ose kontraktin detyra, përfaqësuesit të autorizuar ose kontraktorit i kërkohet, që në kryerjen e këtyre detyrave, të përmbushë detyrimet e vendosura ndaj Autoriteteve kompetente nga ky udhëzim.

5. Në rastin kur Autoriteti delegon ose kontraktin detyra, ai organizon një sistem për të kontrolluar se si kryen detyrat dhe siguron përmbushjen e kushteve të përcaktuara në paragrafët 2, 4 dhe 5.

Neni 26

Akreditimi dhe njohja

1. Personat dhe organet, që duhen akredituar sipas kërkesave të këtij udhëzimi, paraqesin kërkesën dhe dëshmi të përshtatshme të aftësive të tyre në fushën përkatëse te Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Shqipërisë. Akreditimi bazohet sipas standardeve evropiane përkatëse të serisë EN 45 000 dhe në vlerësimin e një dosjeje të paraqitur nga kandidatët.

2. Autoriteti siguron publikimin dhe përditësimin e një regjistri të personave dhe organeve që janë akredituar ose njohur sipas këtij udhëzimi.

Neni 27

Vendimet e Autoritetit

1. Autoriteti së bashku me vendimet që merr shpall dhe arsyet e atyre vendimeve.

2. Autoriteti siguron ankimimin administrativ që lejon punëdhënësit dhe makinistët të kërkojnë rishikimin e një vendimi në lidhje me çdo kërkesë sipas këtij udhëzimi.

3. Vendimet e autoritetit ankimohen edhe tek Autoriteti Rregullator Hekurudhor dhe janë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Neni 28

Regjistrat dhe shkëmbimi i informacionit

1. Autoriteti:

a) mban një regjistër të të gjitha licencave të lëshuara, të përditësuara, të rinovuara, të ndryshuara, të skaduara, të pezulluara, të hequra ose të raportuara të humbura, të vjedhura ose të shkatërruara. Ky regjistër përmban të dhënat e përshkruara në seksionin 4 të aneksit I për çdo licencë, e cila është e aksesueshme, duke përdorur numrin kombëtar të caktuar për çdo makinist. Regjistri përditësohet rregullisht;

b) me kërkesë të arsyetuar ose të dakordësuar më parë i jep informacion mbi statusin e licencave Agjencisë, autoriteteve kompetente të shteteve, sipas marrëveshjeve ose çdo punëdhënësi të makinistëve.

2. Çdo sipërmarrje hekurudhore dhe administrator i infrastrukturës:

a) mban një regjistër për të gjitha certifikatat e lëshuara, të përditësuara, të rinovuara, të ndryshuara, të skaduara, të pezulluara, të tërhequra ose të raportuara të humbura, të vjedhura ose të shkatërruara. Ky regjistër përmban të dhënat e përshkruara në seksionin 4 të aneksit I për çdo certifikatë, si dhe të dhënat në lidhje me kontrollet periodike të parashikuara në nenin 22. Ai përditësohet rregullisht;

b) bashkëpunon me Autoritetin për të shkëmbyer informacion dhe për t'i dhënë atij akses në të dhënat e kërkuara;

c) u japin informacion mbi përmbajtjen e këtyre certifikatave, autoriteteve kompetente të shteteve të tjera sipas marrëveshjeve paraprake.

3. Makinistët kanë akses në të dhënat në lidhje me ta, të cilat ruhen në regjistrat e autoriteteve kompetente dhe të sipërmarrjeve hekurudhore, dhe iu jepet një kopje e këtyre të dhënave sipas kërkesës.

4. Autoriteti bashkëpunon me Agjencinë për të garantuar ndërveprimin e regjistrave të parashikuar në paragrafët 1 dhe 2.

5. Autoriteti, administratorët e infrastrukturës dhe sipërmarrjet hekurudhore sigurojnë që regjistrat e parashikuar në paragrafët 1 dhe 2 dhe mënyrat e funksionimit të këtyre regjistrave të jenë në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

KREU VI TRAJNIMI I MAKINISTËVE

Neni 29

Trajnimi i makinistëve

1. Trajnimi i makinistëve përfshin pjesën që lidhet me licencën dhe pasqyron njohuri të përgjithshme profesionale, siç përshkruhet në aneksin IV, dhe pjesën që lidhet me certifikatën që pasqyron njohuri specifike profesionale, siç përshkruhet në anekset V dhe VI.

2. Metoda e trajnimit duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në aneksin III.

3. Objektivat e detajuar të trajnimit përcaktohen në aneksin IV për licencën dhe në anekset V dhe VI për certifikatën. Këta objektiva të detajuar trajnimi plotësohen nga kushtet teknike të ndërveprimit TSI-të, në përputhje me nenin 133, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", dhe anekseve IV, V dhe VI.

4. Të gjithë kandidatët kanë akses të drejtë dhe të barabartë në trajnimin e nevojshëm për të përmbushur kushtet për marrjen e certifikatës.

5. Detyrat e trajnimit, në lidhje me njohuritë e përgjithshme profesionale, siç parashikohet në nenin 18, pika 4, njohuritë gjuhësore, siç parashikohen në nenin 20, pika 1, dhe njohuritë profesionale, në lidhje me mjetet hekurudhore, siç parashikohet në nenin 20, pika 2, kryhen nga persona të certifikuar tek Agjencia e Bashkimit Evropian për Hekurudhat, ose nga organe të akredituar ose të njohur, në përputhje me nenin 26.

6. Detyrat e trajnimit në lidhje me njohuritë e infrastrukturës, siç parashikohet në nenin 20, pika 3, duke përfshirë njohuritë e infrastrukturës, rregullat dhe procedurat e funksionimit, kryhen nga persona ose organe të akredituar ose të njohur.

7. Njohjen e kualifikimeve profesionale të makinistëve me shtetet e tjera do të bëhet sipas marrëveshjeve hekurudhore përkatëse.

8. Ruajtjen e kompetencave të makinistëve realizohet sipas një procesi trajnimi të vazhdueshëm, në përputhje me nenin 64, pikën 2, shkronja "d", të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë".

Neni 30

Kostoja e trajnimit

1. Kostoja e trajnimit të qendrës së formimit profesional vendoset në zbatim të nenit 68, pika 5, e ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë".

2. Një makinist, nuk mund të ndryshojë sipërmarrjen hekurudhore ose administratorin e infrastrukturës ku është trajnuar, licencuar dhe certifikuar, për të punuar në ndonjë sipërmarrje hekurudhore ose administrator infrastrukture tjetër, pa miratimin e së parës. Kjo masë është për të garantuar investimet e bëra nga subjekti trajnues i makinistit.

KREU VII TESTIMI I MAKINISTËVE

Neni 31

Pavarësia dhe paanshmëria

Kërkuesit për testues konfirmojnë zhvillimin e provimeve në mënyrë të paanshme dhe jodiskriminuese, pa asnjë presion dhe nxitje që mund të ndikojë në gjykimin ose rezultatet e provimit dhe mënyrën e kryerjes së provimit.

Për këtë qëllim, kërkuesi nënshkruan një deklaratë të përfshirë në një formular të dhënë nga Autoriteti.

Neni 32

Kërkesat e kompetencës për testuesit

1. Kërkuesit për testues duhet të jenë kompetent dhe me përvojë, në lidhje me lëndën e provimit që testojnë dhe të certifikuar nga Agjencia.

Përvoja përfshin praktikën profesionale me kohëzgjatje minimale 4-vjeçare brenda një periudhe jo më shumë se 5 vjet përpara datës së kërimit. Periudha e kërkuar e përvojës profesionale përfshin periudha të përvojës si përgjegjës treni që zotëron një licencë të vlefshme makinisti dhe certifikatë plotësuese, praktikë profesionale në drejtimin e mjeteve hekurudhore ose si trajnues për detyrat e trajnimit që lidhen me kërkesën e paraqitur. Njohuritë duhet të jenë të përditësuara në momentin e paraqitjes së kërkesës.

2. Në lidhje me provimet praktike në bordin e trenave, kërkuesi duhet të jetë mbajtës i një licence të vlefshme makinisti dhe një certifikate të vlefshme që mbulon linjën hekurudhore ku zhvillohet provimi. Kur testuesi nuk ka një certifikatë të vlefshme për infrastrukturën hekurudhore të provimit, në provim të jetë i pranishëm një makinist që mban certifikatën për atë infrastrukturë hekurudhore, në përputhje me nenin 14, pika 2, shkronja “e”, e këtij udhëzimi.

3. Përveç kësaj duhet të plotësojnë kriteret minimale të mëposhtme:

a) të jenë kompetent dhe të pajisur me dëshmi për nivelin minimal B2 të Kornizës Evropiane për Kompetencën Gjuhësore (EFLC) në gjuhën e provimit;

b) të kenë aftësitë pedagogjike të nevojshme për kryerjen e provimeve dhe të kenë njohuri të plotë të metodave përkatëse të provimit dhe dokumenteve të provimit;

c) të mbajnë të përditësuara nëpërmjet dëshmimeve kompetencat e tyre profesionale, në lidhje me lëndët që shqyrtojnë;

d) të njohin skemën e certifikimit të makinistëve.

Neni 33

Kërkesat për njohjen si testues

1. Cilido që kërkon njohjen si testues duhet t'i paraqesë një kërkesë me shkrim Autoritetit.

2. Në rastin kur ka të bëjë me njohjen si testues për njohuritë e infrastrukturës, duke përfshirë njohuritë e infrastrukturës dhe rregullat e funksionimit, Autoriteti është përgjegjës për njohjen.

3. Kërkesa mund të paraqitet edhe nga punëdhënësi i tij/saj.

4. Kërkesat përfshijnë dokumente që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim.

5. Kërkesat specifikojnë fushën/at e kompetencës për të cilën kërkohet njohja si testues, në përputhje me:

a) njohuri të përgjithshme profesionale, në përputhje me aneksin IV të këtij udhëzimi;

b) njohuri profesionale në lidhje me mjetet hekurudhore, në përputhje me aneksin V të këtij udhëzimi;

c) njohuri profesionale në lidhje me infrastrukturën, në përputhje me aneksin VI të këtij udhëzimi;

d) njohuri gjuhësore, në përputhje me aneksin VI të këtij udhëzimi.

Neni 34

Lëshimi i deklaratës së njohjes për një testues

1. Autoriteti vlerëson të gjitha dokumentet e dorëzuara nga kërkuesi. Kur plotësohen të gjitha kushtet, lëshon një deklaratë njohjeje sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 2 muaj pas marrjes së të gjitha dokumenteve të nevojshme.

2. Deklarata e njohjes përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe adresën e Autoritetit;
- b) emrin, adresën dhe datën e lindjes së kërkuesit; vendi i lindjes së kërkuesit mund të përfshihet në deklaratën e njohjes në mënyrë fakultative;
- c) fusha/t e kompetencës për të cilën testuesi ka të drejtë të kryejë ekzaminime;
- d) gjuhët në të cilat testuesi njihet për të kryer provimet;
- e) numrin e identifikimit të testuesit të dhënë, në përputhje me nenin 9, shkronja “d”;
- f) data e skadimit të deklaratës së njohjes.

Neni 35

Vlefshmëria, ndryshimi, rinovimi i deklaratës së njohjes për një testues

1. Deklarata e njohjes së një testuesi është e vlefshme për 5 vjet. Autoriteti mund të shkurtojë kohëzgjatjen e vlefshmërisë, në lidhje me të gjitha ose një pjesë të fushave të kompetencës të specifikuar në deklaratën e njohjes në rastet e arsyetuara.

2. Mbajtësi i një deklaratë të vlefshme njohjeje mund të kërkojë në çdo kohë për shtim të fushave të kompetencës mbi gjykimin e së cilës lëshohet deklaratë njohjeje e ndryshuar por pa ndryshuar afatin e vlefshmërisë.

3. Në rast zhvillimesh që kërkojnë një ndryshim në deklaratën e njohjes për shkak se kërkesat për një ose më shumë fusha të kompetencës të specifikuar në të, nuk plotësohen më, testuesi i njohur ndërpret menjëherë kryerjen e provimeve në ato fusha të kompetencës dhe informon me shkrim Autoritetin i cili vlerëson informacionin dhe lëshon një deklaratë të ndryshuar të njohjes por pa ndryshuar afatin e vlefshmërisë.

4. Deklarata e njohjes rinovohet me kërkesë të testuesit dhe lëshohet në të njëjtat kushte si një deklaratë fillestare e njohjes. Autoriteti vendos një procedurë të thjeshtuar kur kushtet për njohjen e mëparshme kanë mbetur të pandryshuara. Në çdo rast testuesit që kërkojnë për rinovim duhet të paraqesin dokumentet e kompetencës që kanë marrë gjatë periudhës së mëparshme të vlefshmërisë dhe të aktiviteteve të ekzaminimit të kryera gjatë 2 vjetëve të fundit. Kur periudha e mëparshme e vlefshmërisë është shkurtuar në më pak se 2 vjet, në përputhje me pikën 1, duhet të dorëzohen përkatësisht regjistrimet e të gjithë periudhës.

Neni 36

Regjistri i testuesve

1. Në regjistrin e përmendur në nenin 26, pika 2, të këtij udhëzimi, çdo testues identifikohet nga një identifikim individual. Numri i identifikimit bazohet në dispozitat kombëtare.

2. Regjistri duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) emri, adresa, data e lindjes së testuesit të njohur;
- b) fushën/at e kompetencës për të cilën testuesi njihet për kryerjen e provimeve;
- c) gjuhë/t në të cilat testuesi njihet për të kryer provimet;
- d) numrin e identifikimit të testuesit të dhënë, në përputhje me pikën 1 të këtij neni;
- e) kur një punëdhënës kërkon në emër të testuesit, në përputhje me nenin 33 pikën 3, emri dhe adresa e punëdhënësit (në raste të tjera emri dhe adresa e një punëdhënësi të testuesit mund të përfshihen në mënyrë fakultative);
- f) data e skadimit të deklaratës së njohjes;

g) informacion kontakti.

3. Për të mbajtur regjistrin të përditësuar, një testues i njohur ose punëdhënësi i tij ose i saj duhet të informojë autoritetin që ka lëshuar deklaratën e njohjes për çdo ndryshim, në lidhje me të dhënat e përfshira në regjistër.

4. Të dhënat e përmendura në pikën 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, duhet të bëhen të aksesueshme për publikun. Të dhëna të tjera të bëhen publike, në përputhje me dispozitat kombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 37

Pezullimi dhe heqja e njohjes

1. Kur aktivitetet e vlerësimit ose mbikëqyrjes të kryera nga Autoriteti, në përputhje me nenin 45 japin dëshmi se një testues nuk i plotëson kërkesat për njohje, Autoriteti heq ose pezullon deklaratën e njohjes.

2. Në këtë rast Autoriteti informon menjëherë testuesin me shkrim për arsyet e vendimeve të tij dhe ia njofton vendimin e tij autoritetit, i cili duhet informuar për mosplotësimin e kërkesave.

Neni 38

Procedura e ankimit

1. Autoriteti siguron informacion të qartë mbi kërkesat që nuk plotësohen më dhe përpara se pezullimi ose heqja të hyjë në fuqi, siguron një periudhë njoftimi brenda së cilës testuesi mund të përshtatë praktikën e tij në mënyrë që të plotësojë kërkesat për njohje. Autoriteti informon menjëherë testuesin me shkrim për arsyet e vendimeve

2. Autoriteti siguron një procedurë ankimit administrativ, e cila lejon kërkimin e rishikimit të vendimeve të kontestuara.

Neni 39

Testuesit që vlerësojnë kompetencën gjuhësore

1. Njohja kërkuesve për të kryer provime si testues i kompetencës së përgjithshme gjuhësore, bëhet në bazë certifikatës të lëshuar, në përputhje me praktikën e zakonshme kombëtare në sektorin e trajnimit gjuhësor.

2. Në lidhje me shqyrtimin e kompetencës për komunikimin dhe terminologjinë specifike për procedurat e funksionimit hekurudhor dhe të sigurisë, kërkohet njohja pranë Autoritetit, në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

KREU VIII

ORGANIZIMI I PROVIMIT

Neni 40

Njohja e qendrave të provimit

1. Cilido që kërkon njohjen e një qendre provimi dorëzon një kërkesë me shkrim pranë Autoritetit.

2. Autoriteti lëshon një deklaratë për njohjen e qendrës së provimit, sipas dispozitave dhe procedurave kombëtare dhe në bazë të kriterëve të pavarësisë, kompetencës dhe paanësisë. Nenet 33 deri në 40 duhet të zbatohen për njohjen e qendrave të provimit.

3. Autoriteti nëse e vlerëson të arsyeshme, u delegon qendrave të provimit njohjen e testuesve të vet, me kusht që ata të përmbushin kërkesat e përcaktuara në pikën 5 të këtij neni.

4. Për qëllim të pikës 6, qendra e provimit mban të përditësuar regjistrin e testuesve i cili përmban informacionin e përmendur në nenin 36, pika 2.

5. Qendra e provimit siguron masat e duhura për të menaxhuar testuesit në mënyrë që të përmbushin kompetencat e kërkuara në këtë udhëzim.

6. Testuesit lejohen të kryejnë provime vetëm në kuadër të aktiviteteve të qendrës së provimit të cilës i përkasin.

7. Informacioni për qendrën e provimit është i aksesueshëm publikisht në regjistrin e parashikuar në nenin 36, pa dhënë informacion për testuesit individualë që i përkasin asaj qendre provimi. Në vend të numrit të identifikimit të përmendur në nenin 36, pika 2, vendoset emri i qendrës së provimit.

8. Autoriteti informon menjëherë qendrën e provimit me shkrim për arsyet e vendimeve të tij.

9. Në rast pezullimi ose heqje të njohjes, Autoriteti siguron informacion të qartë mbi kërkesat që nuk plotësohen më dhe përpara se pezullimi ose heqja të hyjë në fuqi, siguron një periudhë brenda së cilës qendra e provimit mund të përshtatë praktikatat e saj në mënyrë që të përmbushë kërkesat për njohje.

10. Autoriteti siguron një procedurë të ankimit administrativ që lejon kërkimin e rishikimit të vendimeve të kontestuar.

Neni 41

Provimet

1. Provimet dhe testuesit e destinuar për kontrollin e kualifikimeve të nevojshme përcaktohen:

a) nga Autoriteti për pjesën që ka të bëjë me licencën dhe përcakton procedurën që duhet ndjekur për marrjen e licencës, në përputhje me nenin 19;

b) nga sipërmarrja hekurudhore ose nga administratori i infrastrukturës për pjesën që ka të bëjë me certifikatën dhe përcaktimit të procedurës që duhet ndjekur për marrjen e certifikatës, në përputhje me nenin 21.

2. Provimet e përmendura në paragrafin 1 mbikëqyren nga testuesit kompetentë, të akredituar ose të njohur, në përputhje me nenin 26 dhe organizohen në atë mënyrë që të shmangët çdo konflikt interesi.

3. Vlerësimi i njohurive të infrastrukturës, duke përfshirë njohuritë e infrastrukturës dhe rregullat e funksionimit, kryhet nga persona ose organe të akredituar ose të njohur.

4. Testimet e përmendura në paragrafin 1, organizohen në mënyrë të tillë që të shmangët çdo konflikt interesi, pa paragjykuar mundësinë që testuesi mund t'i përkasë sipërmarrjes hekurudhore ose administratorit të infrastrukturës që lëshon certifikatën.

5. Në përfundim të kursit të trajnimit organizohen provime teorike dhe praktike. Aftësia e drejtimit vlerësohet gjatë testeve të drejtimit në rrjetin hekurudhor, duke përdorur simulues të nevojshëm për të testuar zbatimin e rregullave operative dhe performancën e makinistit në situata veçanërisht të vështira.

Neni 42

Kriteret e përbashkëta për organizimin e provimeve

Provimet e organizuara për të vlerësuar kompetencën e makinistëve duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) në rast të provimeve të kryera nga dy ose më shumë persona, së paku personi që udhëheq provimin të jetë testues i njohur, në përputhje me dispozitat e këtij vendimi;

b) kur provimi ka të bëjë me pjesën praktike të kompetencave të drejtimit të trenit, testuesi të jetë i licencuar si makinist dhe të ketë një certifikatë që autorizon përdorimin e infrastrukturës dhe drejtimin e mjeteve hekurudhore që i nënshtrohen testimit. Kur testuesi nuk zotëron një certifikatë të vlefshme për infrastrukturën/mjetet hekurudhore të provimit, të jetë i pranishëm në provim një makinist që mban certifikatën për atë infrastrukturë/mjete hekurudhore, në përputhje me nenin 14, pika 2, shkronja “e”, e këtij udhëzimi;

c) testimet kryhen në mënyrë transparente dhe me kohëzgjatje të mjaftueshme në zbatim të anekseve përkatëse të këtij udhëzimi;

d) në rastet kur testuesi pjesëmarrës në provim ka dhënë trajnimin për lëndën e provimit për makinistin ose kandidatin për makinist, provimin e zhvillon një testues i dytë, i cili nuk ka qenë i përfshirë në trajnimin përgatitor;

e) provimi përgatitet me kujdes të veçantë në lidhje me konfidencialitetin e pyetjeve që bëhen gjatë provimit.

Neni 43

Linja e re hekurudhore dhe mjetet hekurudhore të sapo futura

Në lidhje me linjat e reja hekurudhore ose mjetet hekurudhore të sapo futura në qarkullim, një testues i njohur mund të kryejë teste në kundërshtim me nenin 42, por kufizohet rreptësisht në rastin kur nuk ka asnjë testues që mban një certifikatë që mbulon linjën e re ose të pajisur rishtazi ose mjetet e reja lëvizëse.

Testuesi plotëson të gjitha kërkesat e tjera të nenit 5, pika 2, shkronja “c”, në lidhje me licencën dhe certifikatën siç parashikohet në nenet 19 dhe 21 të këtij udhëzimi dhe për periudhën e kërkuar të praktikës profesionale.

Neni 44

Rregulla transparente të vlerësimit

1. Parimet e vlerësimit dhe pikëzimit dhe lloji i rezultateve publikohen përpara provimeve.

2. Makinistët ose kandidatët për makinistë lejohen të shohin vlerësimin e rezultateve të provimit dhe të kërkojnë rishikim, në rast të një mendimi negativ të arsyetuar në lidhje me provimet që kanë marrë.

3. Makinistët ose kandidatët për makinistë që nuk marrin rezultate pozitive dy herë radhazi, merren në testim pas një viti.

KREU IX

KONTROLLET DHE SANKSIONET

Neni 45

Kontrollet

1. Autoriteti verifikon në çdo kohë, në bordin e trenave, që makinisti posedon dokumentet e lëshuara, në përputhje me këtë udhëzim.

2. Pavarësisht nga verifikimi i parashikuar në paragrafin 1, në rast neglizhence në vendin e punës, Autoriteti mund të verifikojë nëse makinisti në fjalë përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 20.

3. Autoriteti kryen kontrole në lidhje me pajtueshmërinë me këtë udhëzim nga makinistët, sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës, testuesit dhe qendrave të formimit profesional, duke ju kërkuar këtyre të fundit:

a) qasje në të gjitha dokumentet për përgatitjen, kryerjen dhe vlerësimin e provimeve;

b) miratimin e një procedure raportimi në mënyrë që informacione të caktuara të jepen rregullisht ose sipas kërkesës;

c) vëzhgim të testeve nga përfaqësues të Autoritetit.

4. Nëse Autoriteti konstaton se një makinist nuk plotëson një ose më shumë kushte të kërkuara, ai merr masat e mëposhtme:

a) në lidhje me një licencë të lëshuar nga Autoriteti, Autoriteti pezullon licencën. Pezullimi do të jetë i përkohshëm ose i përhershëm në varësi të shkallës së problemeve të krijuara për sigurinë hekurudhore. Ai informon menjëherë makinistin dhe punëdhënësin e tij për vendimin e arsyetuar, pa cenuar të drejtën e rishikimit të parashikuar në nenin 27. Ai tregon procedurën që duhet ndjekur për rikuperimin e licencës;

b) në lidhje me një licencë të lëshuar në një shtet tjetër anëtar, Autoriteti do t'i drejtohet atij autoriteti dhe do të japë një kërkesë të arsyetuar ose që të kryhet një inspektim i mëtejshëm ose që licenca të pezullohet. Autoriteti kërkues informon autoritetet e tjera kompetente për kërkesën e tij;

c) në lidhje me një certifikatë, Autoriteti i drejtohet organit lëshues dhe kërkon ose të kryhet një inspektim i mëtejshëm ose që certifikata të pezullohet. Organi lëshues merr masat e duhura dhe raporton pranë Autoritetit brenda një periudhe prej katër javësh. Autoriteti mund të ndalojë makinistët që të operojnë në zonën e tij të juridiksionit në pritje të raportit të organit lëshues.

Në çdo rast, nëse Autoriteti konsideron se një makinist i caktuar, krijon një kërcënim serioz për sigurinë e hekurudhave, ai ndërmerr menjëherë veprimet e nevojshme, si p.sh. i kërkon administratorit të infrastrukturës të ndalojë trenin dhe ndalon makinistin të operojë për aq kohë sa është e nevojshme.

Në të gjitha rastet, Autoriteti, ose organi i caktuar për këtë, përditëson regjistrin e parashikuar në nenin 28.

Neni 46

Sanksionet

Për shkeljet e dispozitave të këtij udhëzimi, aplikohen gjoba dhe sanksione, në përputhje me legjislacionin në fushën e transportit hekurudhor dhe të kundërvajtjeve administrative në Republikën e Shqipërisë.

KREU X

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 47

Vlefshmëria, marrja dhe rinovimi licencës dhe certifikatave

1. Licencat dhe certifikatat për makinistët të lëshuara, në përputhje me dispozitat që zbatoheshin përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do vazhdojnë të jenë të vlefshme për një periudhë dyvjeçare nga hyrja në fuqi.

2. Marrja dhe rinovimi licencës dhe certifikatave pas hyrjes në fuqi, do të bëhet sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

3. Nëse një sipërmarrje hekurudhore ose një administrator infrastrukture ka testues për qëllimin e kryerjes së provimeve për stafin e tyre, në përputhje me dispozitat dhe kërkesat kombëtare të zbatueshme përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, testuesit vazhdojnë kryerjen e provimeve, në përputhje me kushtet e mëposhtme:

i. sipërmarrja hekurudhore ose administratori i infrastrukturës ka zgjedhur testuesin brenda kornizës së një certifikate sigurie ose autorizimi sigurie të lëshuar nga Autoriteti dhe deri në skadimin e kësaj certifikate sigurie ose autorizimi sigurie;

ii. sipërmarrja hekurudhore ose administratori i infrastrukturës kontrollojnë përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim në lidhje me testuesit që kanë dhe nëse një testues nuk arrin të përmbushë një kërkesë, marrin masat e duhura për përmbushjen e kërkesave.

4. Autoriteti, sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës sigurojnë zbatimin gradual të kontrolleve periodike që korrespondojnë me ato të parashikuara në nenin 22, për makinistët që nuk kanë licenca dhe certifikata, në përputhje me këtë udhëzim.

Neni 48

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE

ANEKSI I
MODELI I LICENCËS DHE I CERTIFIKATËS

1. KARAKTERISTIKAT E LICENCËS

Karakteristikat fizike të licencës së makinistit të jenë në përputhje me standardet ISO/IEC 7810:2003, Kartat e identifikimit - Karakteristikat fizike dhe mikroçipi në licencë të jetë në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 7816-1:1998 Kartat e identifikimit - Kartat e qarqeve të integruara me kontakte - Pjesa 1: Karakteristikat fizike.

Kartoni të jetë prej polikarbonati.

Metodat për verifikimin e karakteristikave të licencës të jenë në përputhje me standardin ISO 10373 -1:2006 Kartat e identifikimit - Metodat e provës - Pjesa 1: Karakteristikat e përgjithshme.

2. PËRMBAJTJA E LICENCËS

Pjesa e përparme e licencës përmban:

a) fjalët “LICENCË MAKINISTI TRENI” të shtypura me shkronja të mëdha në gjuhën shqipe;

b) majtas lart AL, shenjën dalluese të Shqipërisë, në përputhje me kodin ISO 3166 të vendit, të printuar në një drejtkëndësh blu dhe të rrethuar me 12 yje të verdha, poshtë emrin e shtetit shqiptar ALBANIA;

c) informacion specifik për licencën e lëshuar, të numëruar si më poshtë:

1. emri i mbajtësit;
2. mbiemri i mbajtësit;
3. datëlindja
4. vendlindja;
- 4.a datën e lëshimit të licencës;
- 4.b data e skadimit të licencës;
- 4.c emrin e autoritetit lëshues;

5. numri i licencës që jep akses në të dhënat në regjistrin kombëtar bazohet në numrin evropian të identifikimit EIN.

Kodi EIN dyshifror për llojin e dokumentit do të jetë si më poshtë:

71 deri në licencën 9 999;

nëse lëshohen më shumë se 9 999 licenca në vit;

72 nëse numëruesi është 10 000 dhe deri në 19 999;

në rastet kur lëshohen më shumë se 19 999 licenca në vit;

73 nëse numëruesi është 20 000 dhe deri në 29 999;

6. një fotografi e mbajtësit;

7. nënshkrimi i mbajtësit;

Ana e pasme përmban:

8. adresa e plotë e vendbanimit;

9. a1. gjuha/ët amtare të makinistit;

a2. të dhëna të veçanta për makinistët që punojnë jashtë vendit;

b1. përdorimi i detyrueshëm i syzeve/thjerrëzave;

b2. përdorimi i detyrueshëm i aparatit të dëgjimit.

Në rast se vendoset informacion shtesë ose kufizime mjekësore për përdorim të vendosura nga një Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, në përputhje me aneksin II, në formë kodi, shtohet në njërën nga kutitë dhe ato që nuk përdoren do të anulohen.

3. PARANDALIMI I PËRDORIMIT TË LICENCËS SË PAVLEFSHME DHE MASAT KUNDËR FALSIFIKIMIT



1. Makinisti, në raste që licenca dëmtohet, ndryshohet informacioni që përmban licenca apo është raportuar si e humbur dhe është gjetur përsëri, duhet t'ia kthejë menjëherë atë autoritetit që e ka lëshuar, në mënyrë që të zëvendësohet dhe licenca e pavlefshme të shkatërrohet.

2. Materiali i përdorur për licencën përbëhet nga karakteristikat e detyrueshme të sigurisë si vijon:

- materiali i licencës të jetë i padepërtueshëm ndaj rrezeve ultraviolette;
- modeli i licencës nuk duhet të përbëhet nga ngjyrat kryesore (CMYK), por duhet të përmbajë të paktën dy ngjyra të veçanta dhe duhet të përfshijë germa mikro;
- licenca të jetë rezistente ndaj falsifikimit nëpërmjet skanimit, printimit ose kopjimit;
- në zonën e fotografisë, fotografia dhe nënshkrimi i sigurisë të mbivendosen në të paktën kufirin e fotografisë.

3. Përveç kësaj, materiali i përdorur për licencë duhet të sigurohet kundër falsifikimit, duke përdorur të paktën një nga teknikat e mëposhtme (karakteristika shtesë të sigurisë):

- bojëra që ndryshojnë ngjyrën;
- bojë termokromike;
- holograme me porosi;
- imazhe laser të ndryshueshme;
- karaktere, simbole ose modele prekëse.

4. Teknikat e përdorura duhet t'u mundësojnë autoriteteve kompetente të kontrollojnë vlefshmërinë e licencës pa ndonjë pajisje speciale.

5. Masat joteknike për të parandaluar falsifikimet lidhen me monitorimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë të vendosur nga sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës.

4. STATUSI I LICENCËS SË MAKINISTIT DHE NUMËRIMI

1. Licenca e drejtuesit të trenit përditësohet, në rastet kur:

a) pas mbarimit të afatit të vlefshmërisë së licencës, pas 10 vjetësh, në licencë zëvendësohet fotoja e mbajtësit me një foto të re dhe ndryshohet data e vlefshmërisë;

b) në qoftë se ndodh ndryshimi i adresës ose i numrit të referencës së punonjësit pasqyrohen ndryshimet në licencë;

c) kur ka ndryshime të gjendjes shëndetësore gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës duhet të pasqyrohen sipas kodeve të përcaktuara në këtë udhëzim. Sipërmarrjet hekurudhore ose administratorët e infrastrukturës që punësojnë ose kontraktajnë makinistë, zbatojnë pa vonesë çdo vendim që rrjedh nga rezultati i kontrolleve mjekësore;

d) të gjitha ndryshimet në statusin e licencës së makinistëve regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Licencave.

2. Numri i licencës caktohet nga Autoriteti ose organi i deleguar gjatë dhënies së licencës dhe ruhet edhe në rast rinovimi, ndryshimi, përditësimi ose lëshimi dublikate.

5. DOKUMENTET E KËRKUARA PËR LICENCË DREJTIMI TRENI

Kërkesa për lëshimin e një licence të re, të rinovuar, të ndryshuar, të përditësuar ose një kopje të saj bëhet sipas paraqitjes të këtyre dokumenteve:

1. formularit të plotësuar të kërkesës së personit ose një subjekti në emër të tij;
2. deklaratës së plotësuar për mbrojtjen e të dhënave personale;
3. dokumentet e kërkuara sipas listës që shoqëron kërkesën dhe
4. udhëzues për formularin e kërkesës.

Dokumentet i jepen për plotësim kërkuar nga Autoriteti.

Formati i kërkesës për licencë:

FORMATI I APLIKIMIT PËR LICENCË DREJTIMIT TË TRENIT

1. INFORMACIONI I KONTAKTIT TË AUTORITETIT TË SIGURISË HEKURUDHORE

1.1 Apikimi për Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore

1.2 Adresa e plotëpostare
Lagjia; Rruga, qyteti, vëndi

2. DETAJET E APLIKIMIT PËR LICENCË

2.1 Kjo Licencë për drejtim treni është (vendosni shënjën + në kutinë e duhur)

2.2 Për herë të parë

2.3 Përditësim /Amendim

2.4 Ripërtëritje

2.5 Dublikatë

2.6 Numri European I Identifikimit të Licencës
EIN .Nuk kërkohet kur aplikon për herë të parë

2.7 Data e lëshimit të parë

2.8 detajet e aplikimit

2.9 Paraqitur nga aplikuesi

2.10 Paraqitur nga subjekti në emër të aplikantit

2.11 Detajet e subjektit që dorëzon kërkesën
në emër të aplikantit

2.12 Statusi i subjektit

2.13 Adrsa postare/Telefon/Email

2.14 Detajet e aplikantit

2.15 Mbiemri

2.16 Emri

2.17 Seksi

Mashkull

Femër

2.18 Data e lindjes

2.19 Vëndi I lindjes

Kombësia

Gjuha amtare

2.20	Numri i referencës i caktuar nga punëdhënësi								
2.21	Adresa postare në të cilën duhet të dërgohet licenca								
2.22	Adresa e përshes L. Rr. Numri								
2.23 FOTO	Kodi postar								
	Qyteti/Bashkia								
	Telefoni								
	Email								
2.24	Rezervuar për të dhëna shtesë të bazuar në legjislacionin kombëtar								
2.25	Rezervuar për të dhëna shtesë të bazuar në legjislacionin kombëtar								
2.26	Rezervuar për të dhëna shtesë të bazuar në legjislacionin kombëtar								
2.27	Deklatroj nën përgjegjësinë time penale se informacioni i dhënë nga ana ime në këtë aplikim dhe cdo faqe bashkëngjitur saj është i vërtetë. Pranoj që aplikimi im mund të refuzohet dhe/ose licenca ime mund të tërhiqet nëse më pas konstatohet se kam dhënë informacion të rremë ose kam mbajtur kopje të të dhënave përkatëse								
2.28	Data								
2.29	Firma e Aplikantit								
2.30	Numri i brendshëm i referencës (opsionale)								
2.31	Data e marrjes së aplikimit								
		Rezervuar për vulën dhe firmën e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore							

Lista e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës:

DOKUMENTET QË DUHET TË DORËZOHEN ME KËRKESËN	Data e mbërritjes
--	-------------------

□ 1. LICENCË E RE

1.1	Formulari i kërkesës i nënshkruar	
1.2	Autorizimi për përpunimin e të dhënave personale	
1.3	Dëshmi për nivelin më të lartë të arsimit	
1.4	Certifikata e aftësisë fizike	
1.5	Certifikatë e aftësisë psikologjike profesionale	

1.6	Certifikata e kompetencës së përgjithshme profesionale	
1.7	Kopje e pasaportës/kartës së identitetit kombëtar/dokument tjetër të njohur që vërteton identitetin	

□ 2. PËRDITËSIM

2.1	Licenca aktuale	
2.2	Arsyetimi për ndryshim në mënyrë që të përditësohen të dhënat	
2.3	...	

□ 3. NDRYSHIM

3.1	Licenca aktuale	
3.2	Certifikata e aftësisë fizike	
3.3	Arsyetimi për ndryshim në mënyrë që të korrigjohen të dhënat	

□ 4. DUBLIKATË

4.1	Deklarimi i arsyes pse kërkohet një kopje (të shkatërruar/vjedhur/raportuar të humbura/të dhënat e ndryshuara)	
4.2	Licenca, vetëm në rast se kërkohet kopja, për shkak se licenca është ndryshuar/dëmtuar	

□ 5. RINOVIM

5.1	Certifikata e aftësisë fizike	
5.2	Kopja e licencës së fundit	
5.3	Dëshmi rinovimi kompetence profesionale (nëse është e kërkueshme)	

Numri i brendshëm i referencës	Data e përfundimit të kërkesës	HAPËSIRË E REZERVUAR PËR VULËN E ZYRËS/AUTORITETIT TË DREJTUAR
--------------------------------	--------------------------------	--

6. CERTIFIKATA

Certifikata përmban:

- a) emri i mbajtësit;
- b) mbiemri i mbajtësit;
- c) datën dhe vendin e lindjes së mbajtësit;
- d) data e lëshimit të certifikatës;
- e) data e skadimit të certifikatës;
- f) emrin e autoritetit lëshues;
- g) numrin e referencës që i është caktuar punëmarrësit nga punëdhënësi (nëse ka);
- h) numrin e licencës që jep akses në të dhënat në regjistrin kombëtar;
- i) një fotografi e mbajtësit;
- j) nënshkrimi i mbajtësit;
- k) adresa e vendbanimit;
- l) emrin dhe adresën e sipërmarrjes hekurudhore ose administratorit të infrastrukturës për të cilën makinisti është i autorizuar të drejtojë trenat;
- m) kategorinë në të cilën mbajtësi ka të drejtë të drejtojë trenat;
- n) llojin ose llojet e mjeteve hekurudhore të cilat mbajtësi është i autorizuar të drejtojë;
- o) infrastrukturën në të cilat mbajtësi është i autorizuar të drejtojë trenat;
- p) çdo informacion ose kufizim shtesë;
- q) aftësitë gjuhësore.

Model i certifikatës plotësuese:

Të dhënat e mëposhtme për mbajtësin do të shfaqen:

- vendi i lindjes (vendi dhe vendi);
- data e lindjes;
- kombësia;
- adresën postare (rruga, kodin postar, qytetin dhe shtetin).

6.3 Kategoritë e drejtimit të trenit

Kategoritë dhe llojet e drejtimit, për të cilat makinisti është i autorizuar të drejtojë, janë:

Kategoria A

Administratorët e infrastrukturës dhe sipërmarrësit hekurudhorë mund të përdorin “A” si një kategori globale, duke përfshirë të gjitha aktivitetet e kategorisë A: lokomotivat manovruese, trenat e punës, mjeteve hekurudhore të mirëmbajtjes dhe të gjitha lokomotivat e tjera kur ato përdoren për manovrim.

Përndryshe, mund të kufizojnë objektin e certifikatës në një ose më shumë nga llojet e mëposhtme:

A1=kur kufizohet në lokomotiva manovruese;

A2=kur kufizohet në trenat e punës;

A3=kur kufizohet në mjeteve hekurudhore të mirëmbajtjes;

A4=kur kufizohet në të gjitha lokomotivat e tjera kur ato përdoren për manovrim;

A5=të tjera, nëse autorizimi ka të bëjë me shërbime ose mjete hekurudhore që nuk përfshihen në kategoritë e mëparshme.

Kategoria B

Administratorët e infrastrukturës dhe sipërmarrësit hekurudhorë mund të përdorin “B” si një kategori globale, që përfshin trenat e pasagjerëve dhe të mallrave.

Përndryshe, mund të kufizojnë objektin e certifikatës në një ose më shumë nga llojet e mëposhtme:

B1=kur kufizohet në transportin e udhëtarëve;

B2=kur kufizohet në transportin e mallrave.

Kategoria në të cilën mbajtësi është i autorizuar të drejtojë do të tregohet duke plotësuar kutinë përkatëse nëse zgjidhet një kategori globale ose kutitë, nëse zgjidhet një ose më shumë nënkategori. Kutitë që nuk janë të nevojshme do të anulohen.

Shembuj:

A	*** *** *** *** ***	=	katgoria globale A. Nuk është përdorur asnjë nënkategori
A	1 *** *** *** ***	=	Kategoria A, nënkategoria 1 (autorizim për të drejtuar vetëm lokomotiva manovruese)
A	2 3 *** *** ***	=	Kategoria A, nënkategoritë 2 dhe 3 (autorizimi për drejtimin e trenave të punës dhe automjeteve të mirëmbajtjes)
A	*** *** *** *** 5	=	Kategoria A, nënkategoria 5 (autorizim në lidhje me shërbimin ose mjetet lëvizëse që nuk korrespondojnë me nënkategoritë nga A1 në A4. Të specifikohet në kutinë “shënime”)
B	*** ***	=	katgoria globale B, nuk përdoret asnjë nënkategori
B	2 ***	=	Kategoria B, nënkategoria 2 (autorizimi për të drejtuar trenat e mallrave)

6.4 Informacion shtesë

Informacion që kërkohet nga legjislacioni kombëtar në fuqi ose nga procedurat e brendshme të kompanisë.

6.5 Të dhëna që lidhen me aftësitë gjuhësore

Lista e gjuhëve, të ndryshme nga gjuha amtare, që zotërojnë dhe iu njihen makinistëve.

6.6 Kufizimet

Kjo pjesë tregon kufizime në lidhje me karakteristikat dhe aftësitë e makinistëve në lidhje me përmbajtjen e certifikatës plotësuese (p.sh.: drejtimi i mjeteve hekurudhore lejohet vetëm gjatë ditës etj.)

Nëse kufizimet kanë të bëjnë me mjetet lëvizëse (p.sh.: kufizimet e shpejtësisë gjatë drejtimit të llojeve të caktuara të lokomotivave) dhe/ose infrastrukturës, informacioni në format teksti duhet të jepet në kutinë “shënime” pranë mjeteve lëvizëse dhe/ose infrastrukturës përkatëse.

6.7 Të dhëna në lidhje me mjetet lëvizëse

Lista e mjeteve lëvizëse që makinisti është i autorizuar të drejtojë në zbatim të këtij udhëzimi.

Të dhënat do të shfaqen në kutinë e mëposhtme:

- një kuti për datën e fillimit të vlefshmërisë së kompetencës përkatëse;
- një kuti për çdo lloj mjeteve hekurudhore;
- një kuti me hapësirë për shënime (ato mund të jenë vula për të konfirmuar kompetencat e fituara, datën e përfundimit të vlefshmërisë së kompetencës ose informacione të tjera përkatëse, siç thuhet në pikën 1.6 më sipër).

6.8 Të dhëna që lidhen me infrastrukturën

Lista infrastrukturës në të cilën makinisti është i autorizuar të drejtojë pas një vlerësimi të kompetencave në zbatim të këtij udhëzimi.

Të dhënat do të shfaqen në kutinë e mëposhtme:

- një kuti për datën e fillimit të vlefshmërisë së kompetencës përkatëse;
- një kuti për shtrirjen e infrastrukturës në të cilën makinisti është i autorizuar të drejtojë;
- një kuti me hapësirë për shënime (ato mund të jenë një vulë për të konfirmuar kompetencat e fituara, datën e përfundimit të vlefshmërisë së kompetencës ose informacione të tjera përkatëse, siç thuhet në pikën 1.6 më sipër).

Shtrirja e infrastrukturës në të cilën makinisti është i autorizuar për të drejtuar trenin përshkruhet në procedurën e sipërmarrjes hekurudhore për lëshimin dhe përditësimin e certifikatës plotësuese. Për çdo pjesë të infrastrukturës në të cilën makinisti është i autorizuar të drejtojë, shtohen informacione ose kufizime përkatëse.

7. KARAKTERISTIKAT FIZIKE TË CERTIFIKATËS PLOTËSUESE

Modeli i certifikatës plotësuese është një dokument i palosshëm, madhësia 10cm × 21cm (kur shpaloset), duke dhënë tri faqe të jashtme dhe tri të brendshme.

Faqja e parë do të shfaqë informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe mbiemrin e mbajtësit;
- numri i licencës;
- datat e lëshimit dhe skadencës së certifikatës plotësuese;
- të dhënat në lidhje me subjektin emetues dhe vulën. Mund të përfshijë një numër të brendshëm të kompanisë për qëllime administrative.

Faqja dy do të përmbajë të dhëna për punëdhënësin dhe të dhëna shtesë për mbajtësin, të numëruara si më poshtë:

1. të dhëna për punëdhënësin;
2. të dhëna për makinistin.

Faqja tre do të përmbajë:

3. kategoritë e drejtimit;
4. informacion shtesë;
5. aftësitë gjuhësore;
6. kufizimet.

Faqet e brendshme duhet të përmbajnë llojet e mjeteve hekurudhore që makinisti është i autorizuar të drejtojë (llojet, data e vlerësimit fillestar) dhe listën e infrastrukturës në të cilën makinisti është i autorizuar të drejtojë.

Mund të shtohen faqe të brendshme shtesë për të përfshirë informacione që tejkalojnë hapësirën e disponueshme.

Certifikata plotësuese duhet të jetë në përputhje me modelin e treguar në seksionin 4.

8. MODELI DHE KARAKTERISTIKAT FIZIKE TË KOPJES SË VËRTETUAR TË CERTIFIKATËS PLOTËSUESE

	zakoni kombëtar		
5	Data e lindjes		
5.1	Data e lindjes së mbajtësit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
6	Vendi i lindjes		
6.1	Vendi i lindjes së mbajtësit	Teksti	E detyrueshme
6.2	Kombësia	Teksti	Fakultative
7	Data e lëshimit të licencës		
7.1	Afishimi i datës aktuale të lëshimit të licencës	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
8	Data e skadimit të licencës		
8.1	Data e skadimit formal të pritshëm të licencës së vlefshme	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
9	Emri i autoritetit lëshues		
9.1	Emri i autoritetit që lëshon licencën (Autoriteti, subjekti i deleguar, ndërmarra hekurudhore, menaxheri i infrastrukturës)	Teksti	E detyrueshme
10	Numri i referencës i caktuar punëmarrësit nga punëdhënësi		
10.1	Referenca e kompanisë për shoferin e trenit	Teksti	Fakultative
11	Fotografia e mbajtësit		
11.1	Fotografi	Skanim origjinal ose elektronik	E detyrueshme
12	Nënshkrimi i mbajtësit		
12.1	Nënshkrimi	Origjinali/fotokopje/skanim elektronik	E detyrueshme
13	Vendbanimi i përhershëm ose adresa postare e mbajtësit		
13.1	Adresa e mbajtësit	Rruga dhe numri	Teksti
13.2		Qyteti	Teksti
13.3		Vendi	Teksti
13.4		Kodi Postar	Kodi alfanumerik
13.5		Numër telefoni	Teksti
13.6		Adresa e-mail-it	Teksti
14	Informacion shtese		
14.1	Informacioni i vendosur nga një Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, në përputhje me aneksin II	Informacion i koduar	E detyrueshme
	Fusha 9.a.1 - Gjuha/ët amtare të makinistit	Teksti	
	Fusha 9.a.2 - Informacion që mund të jetë i nevojshëm sipas legjislacionit kombëtar	Teksti	
15	Kufizimi mjekësor		
15.1	Informacioni i vendosur nga një Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, në përputhje me aneksin II	Informacion i koduar	E detyrueshme
	Përdorimi i detyrueshëm i syzeve/thjerrëzave	(kodi b.1)	
	Përdorimi i detyrueshëm i aparateve të dëgjimit	(kodi b.2)	

Seksioni 3. Informacion historik mbi statusin e licencës dhe rezultatet e kontrolleve periodike

16	Data e regjistrimit të parë		
16.1	Data e lëshimit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
17	Data e skadencës		
17.1	Data e skadimit (dhe e rinovimit të pritshëm zyrtar)	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
18	Përditësim/et (janë të mundshme disa regjistrime)		
18.1	Data e përditësimit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
18.2	Arsyeja e përditësimit	Teksti	E detyrueshme
19	Amendament/et (disa regjistrime janë të mundshme)		
19.1	Data e ndryshimit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
19.2	Arsyeja e ndryshimit	Teksti	E detyrueshme
20	Pezullimi/et (janë të mundshme disa regjistrime)		
20.1	Kohëzgjatja e periudhës së pezullimit	Nga (data) në (datë)	E detyrueshme
20.2	Arsyeja e pezullimit	Teksti	E detyrueshme
21	Tërheqja/t (janë të mundshme disa regjistrime)		
21.1	Data e tërheqjes	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
21.2	Arsyeja e tërheqjes	Teksti	E detyrueshme
22	Licenca raportohet e humbur		
22.1	Data e komunikimit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
22.2	Data e çdo dublikate të lëshuar	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
23	Licenca raportohet e vjedhur		
23.1	Data e komunikimit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
23.2	Data e çdo dublikate të lëshuar	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
24	Licenca raportohet e shkatërruar		
24.1	Data e komunikimit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
24.2	Data e çdo dublikate të lëshuar	YYYY-MM-DD	E detyrueshme

Seksioni 4. Informacion mbi kërkesat bazë për lëshimin e licencës dhe rezultatet e kontrolleve periodike

25	Arsimi			
25.1	Kërkesa bazë	Niveli më i lartë i certifikimit të zotëruar	Teksti	E detyrueshme
26	Aftësitë fizike			
26.1	Kërkesa bazë	Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve sipas shtojcës II	Teksti	E detyrueshme
26.2	Data e kontrollit		YYYY-MM-DD	E detyrueshme
26.3	Kontroll periodik pasues	E konfirmuar/jo e konfirmuar	Teksti	E detyrueshme
26.4	(disa regjistrime të mundshme)	Data e kontrollit të fundit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
26.5	Kontrolli i radhës	Data e kontrollit tjetër të pritur zyrtarisht	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
26.6	Shënime	Shënime që duhen specifikuar: - Orari normal, - Orari i parashikuar (sipas certifikatës së mjekut) - Ndryshimi i informacionit (kodi 9.a.2) nëse është e nevojshme - Ndryshimi në kodin e kufizimit - Fusha tjetër + për të specifikuar	Teksti	E detyrueshme
27	Përshtatshmëria psikologjike profesionale			
27.1	Kërkesa bazë	Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve në aneksin II	Teksti	E detyrueshme
27.2	Data e kontrollit		YYYY-MM-DD	E detyrueshme
27.3	Kontrollet në vijim	Vetëm nëse është e nevojshme (disa regjistrime të mundshme)	deklaratë	E detyrueshme
27.4		Data e çdo kontrolli të mëpasshëm	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
28	Njohuri të përgjithshme profesionale			
28.1	Kërkesa bazë	Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve në aneksin IV	Teksti	E detyrueshme
28.2	Data e kontrollit		YYYY-MM-DD	E detyrueshme
28.3	Kontrolli pasues	(vetëm nëse kërkohet në nivel kombëtar)	YYYY-MM-DD	E detyrueshme

b) Të dhënat në lidhje me certifikatën:

Të gjitha të dhënat që shfaqen në certifikatë plus të dhënat në lidhje me kërkesat e kontrollit të përcaktuara në nenet 20, 21 dhe 22.

Seksioni 1. Referenca për licencën

1	Numri i licencës			
1.1	Numri i licencës, që jep akses në të dhënat në regjistrin kombëtar		EIN (12 shifra)	E detyrueshme
2	Gjendja aktuale e licencës			
2.1	Dëshmi për gjendjen aktuale të licencës - e vlefshme - i pezulluar - i tërhequr		Teksti	E detyrueshme

Seksioni 2. Informacion në lidhje me certifikatën aktuale plotësuese të lësuar, siç renditet në aneksin I

3	Emri i mbajtësit (i njëjtë me licencën)			
3.1	Emri/at i shfaqur në pasaportë ose kartë identiteti kombëtar ose dokument tjetër të njohur që vërteton identitetin. Më shumë emra lejohen, në varësi të zakonit kombëtar		Teksti	E detyrueshme
4	Mbiemri i mbajtësit (i njëjtë me licencën)			
4.1	Mbiemri/at i shfaqur në pasaportë ose kartë identiteti kombëtar ose dokument tjetër të njohur që vërteton identitetin. Lejohen më shumë mbiemra, në varësi të zakonit kombëtar		Teksti	E detyrueshme
5	Data e lindjes së mbajtësit			
5.1	Data e lindjes së mbajtësit		YYYY-MM-DD	E detyrueshme
6	Vendi i lindjes së mbajtësit			
6.1	Vendi i lindjes së mbajtësit		Teksti	E detyrueshme
7	Data e lëshimit të certifikatës			
7.1	Data aktuale e lëshimit të certifikatës		YYYY-MM-DD	E detyrueshme
8	Data e skadimit të certifikatës			
8.1	Data e skadimit zyrtar të pritshëm të certifikatës, që do të përcaktohet nga kompania dhe do të përfshihet në procedurën e		YYYY-MM-DD	E detyrueshme

	kërkuar në nenin 21 të këtij udhëzimi		
9	Emri i subjektit lëshues		
9.1	Emri i subjektit që lëshon certifikatën (sipërmarrje hekurudhore, administrator infrastrukture, të tjera)	Teksti	E detyrueshme
10	Numri i referencës i caktuar punëmarrësit nga punëdhënësi		
10.1	Referenca e kompanisë për makinistin	Teksti	Fakultative
11	Fotografia e mbajtësit		
11.1	Fotografi	Skanim origjinal ose elektronik	E detyrueshme
12	Nënshkrimi i mbajtësit		
12.1	Nënshkrimi	Origjinali/fotokopje/skanim elektronik	E detyrueshme
13	Vendbanimi i përhershëm ose adresa postare e mbajtësit		
13.1	Adresa e mbajtësit	Rruga dhe numri	Teksti
13.2		Qyteti	Teksti
13.3		Vendi	Teksti
13.4		Kodi postar	Kodi alfanumerik
13.5		Numër telefoni	
13.6		adresa <i>e-mail</i>	
14	Adresa e sipërmarrjes hekurudhore ose administratorit të infrastrukturës për të cilën makinisti është i autorizuar të drejtojë		
14.1	Adresa e sipërmarrjes hekurudhore ose administratorit të infrastrukturës	Rruga dhe numri	Teksti
14.2		Qyteti	Qyteti
14.3		Vendi	Teksti
14.4		Kodi postar	Kodi alfanumerik
14.5		Personi kontaktues	Teksti
14.6		Numër telefoni	Teksti
14.7		Numri i faksit	Teksti
14.8		Adresa <i>e-mail</i>	Teksti
15	Kategoria në të cilën makinisti është i autorizuar të drejtojë		
15.1	Kodi/et përkatës	Teksti	E detyrueshme
16	Mjetet hekurudhore të cilat makinisti është i autorizuar ta drejtojë		
16.1	(Lista, regjistrimi që do të përsëritet)	Teksti	E detyrueshme
16.2	Për çdo kategori do të shtohet data e kontrollit të ardhshëm të pritshëm	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
17	Infrastruktura në të cilën makinisti është i autorizuar për të drejtuar		
17.1	(Lista, regjistrimi që do të përsëritet)	Teksti	E detyrueshme
17.2	Për çdo kategori do të shtohet data e kontrollit të ardhshëm të pritshëm	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
18	Aftësitë gjuhësore		
18.1	(Lista, regjistrimi që do të përsëritet)	Teksti	E detyrueshme
18.2	Për çdo kategori do të shtohet data e kontrollit të ardhshëm të pritshëm	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
19	Informacion shtesë		
19.1	(Lista, regjistrimi që do të përsëritet)	Teksti	E detyrueshme
20	Kufizime shtesë		
20.1	(Lista, regjistrimi që do të përsëritet)	Teksti	E detyrueshme

Seksioni 3. Të dhënat historike mbi statusin e certifikatës plotësuese

21	Data e regjistrimit		
21.1	Data e lëshimit të parë të certifikatës	YYYY-MM-DD	Fakultative
22	Përditësim/et (janë të mundshme disa regjistrime)		
22.1	Data e përditësimit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
22.2	Detajet dhe arsyeja e përditësimit (korrigjimi i një ose më shumë të dhënave të shfaqura në certifikatën plotësuese, p.sh. adresa personale e shoferit)	Teksti	E detyrueshme
23	Amendament/et (disa regjistrime janë të mundshme)		
23.1	Data e ndryshimit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
	Arsyeja e ndryshimeve, duke iu referuar pjesëve specifike të certifikatës: - ndryshime në fushën 3, “Kategoritë e drejtimit të automjeteve” -ndryshime në fushën 4, “Informacion shtesë” - ndryshime në fushën 5: Njohuri të reja gjuhësore të marra ose njohuri të kontrolluara periodikisht -amendamentet në fushën 6, “Kufizimet” - ndryshimet në kolonën 7: Njohuritë e marra për mjetet lëvizëse të reja ose njohuritë e kontrolluara periodikisht	Teksti	E detyrueshme

	- ndryshimet në kolonën 8: Njohuritë e reja të infrastrukturës të marra ose njohuri të kontrolluara periodikisht		
24	Pezullimi/et (janë të mundshme disa regjistrime)		
24.1	Kohëzgjatja e periudhës së pezullimit	Nga (data) në (datë)	E detyrueshme
24.2	Arsyeja e pezullimit	Teksti	E detyrueshme
25	Tërheqja/t (janë të mundshme disa regjistrime)		
25.1	Data e tërheqjes	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
25.2	Arsyeja e tërheqjes	Teksti	E detyrueshme
26	Certifikata u raportua e humbur		
26.1	Data e komunikimit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
26.2	Nëse po, data e kopjimit të lëshuar	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
27	Certifikata u raportua e vjedhur		
27.1	Data e komunikimit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
27.2	Data e çdo dublikate të lëshuar	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
28	Certifikata u raportua e shkatërruar		
28.1	Data e komunikimit	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
28.2	Data e çdo dublikate të lëshuar	YYYY-MM-DD	E detyrueshme

Seksioni 4. Regjistrimet në lidhje me kërkesat bazë për lëshimin e një certificate plotësuese dhe rezultatet e kontrolleve periodike

29	Kompetenca gjuhësore			
29.1	Kërkesa bazë	Gjuhë/t për të cilat është lëshuar një deklaratë se kriteret e përcaktuara në aneksin VI janë përmbushur.	Teksti	E detyrueshme
29.2	Kontroll periodik	Data e certifikimit të njohurive (provimit të kaluar) për çdo gjuhë. Disa regjistrime janë të mundshme.	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
30	Njohuri për mjetet hekurudhore			
30.1	Kërkesa bazë	Mjetet hekurudhore për të cilat janë plotësuar kriteret e përcaktuara në aneksin V.	Teksti	E detyrueshme
30.2	Kontroll periodik	Data e kontrollit periodik (njohuri e vërtetuar) Disa regjistrime janë të mundshme.	YYYY-MM-DD	E detyrueshme
31	Njohuri për infrastrukturën			
31.1	Kërkesa bazë	Infrastruktura për të cilën u lëshua një deklaratë se janë përmbushur kriteret e përcaktuara në aneksin VI	Teksti	E detyrueshme
31.2	Kontroll periodik	Data e kontrollit periodik (njohuri e vërtetuar) Disa regjistrime janë të mundshme	YYYY-MM-DD	E detyrueshme

ANEKSI II KËRKESAT MJEKËSORE

1. KËRKESAT E PËRGJITHSHME

1.1 Makinistët nuk duhet të vuajnë nga ndonjë gjendje mjekësore ose të marrin ndonjë medikament, ilaç ose substancë që ka të ngjarë të shkaktojë:

- humbje e papritur e vetëdijes;
- ulje e vëmendjes ose përqendrimit;
- paaftësia e papritur;
- një humbje e ekuilibrit ose koordinimit;
- kufizim i konsiderueshëm i lëvizshmërisë.

1.2 Shikimi

Duhet të zbatohen kërkesat e mëposhtme në lidhje me shikimin:

- mprehtësia vizuale në distancë me ndihmë ose pa ndihmë: 1,0; minimumi 0,5 për syrin më të keq;
- lente korigjuese maksimale: hipermetropi + 5/miopi -8. Përjashtimet lejohen në raste të jashtëzakonshme dhe pasi të jetë marrë mendimi i një specialisti të syrit. Më pas mjeku merr vendimin;
- shikimi i afërt dhe i ndërmjetëm: i mjaftueshëm, qoftë i ndihmuar apo i pandihmuar;
- lentet dhe syzet e kontaktit autorizohen kur kontrollohen periodikisht nga një specialist,
- vizioni normal i ngjyrave: përdorimi i një testi të njohur, siç është Ishihara, si dhe një test tjetër i njohur nëse kërkohet;
- fusha e shikimit: e plotë,

- vizioni për të dy sytë: efektiv; nuk kërkohet kur personi ka përshtatje adekuate dhe përvojë të mjaftueshme kompensimi. Vetëm në rast se ai humbi shikimin dylbi pasi filloi punën e tij;
- shikimi binocular: efektiv;
- njohja e sinjaleve të ngjyrave: testi duhet të bazohet në njohjen e ngjyrave të vetme dhe jo në dallimet relative;
- ndjeshmëria ndaj kontrasteve: mirë;
- nuk ka sëmundje progresive të syve;
- implantet e lenteve, keratotomitë dhe keratektomitë lejohen vetëm me kusht që ato të kontrollohen çdo vit ose në intervale të caktuara nga mjeku;
- aftësia për të përballuar verbimin;
- lentet e kontaktit me ngjyra dhe lentet fotokromatike nuk lejohen. Lejohen lentet e filtrit UV.

1.3 Kërkesat e dëgjimit dhe të folurit

Dëgjim i mjaftueshëm i konfirmuar nga një audiogram, p.sh.

- dëgjimi mjaftueshëm i mirë për të zhvilluar një bisedë telefonike dhe për të qenë në gjendje të dëgjojë tinguj paralajmërues dhe mesazhe radio;
- Vlerat e mëposhtme duhet të merren si udhëzime:
 - mungesa e dëgjimit nuk duhet të jetë më e lartë se 40 dB në 500 dhe 1 000 Hz;
 - mungesa e dëgjimit nuk duhet të jetë më e lartë se 45 dB në 2000 Hz për veshin me përcjelljen më të keqe të ajrit të zërit;
 - nuk ka anomali të sistemit vestibular;
 - pa çrregullime kronike të folurit (duke pasur parasysh nevojën për të shkëmbyer mesazhe me zë të lartë dhe të qartë);
 - përdorimi i aparateve të dëgjimit lejohet në raste të veçanta.

1.4 Shtatzënia

Shtatzënia konsiderohet si një arsye për ndalimin e përkohshëm të makinistëve të drejtojnë trenat. Duhet të zbatohen dispozitat ligjore që mbrojnë makinistët shtatzëna.

2. KONTROLLET SHËNDETËSORE PARA DHËNIES SË PROVIMIT

2.1 Kontrollat mjekësore duhet të dokumentohen me:

- një ekzaminim të përgjithshëm mjekësor;
- testimet e funksioneve shqisore (shikimi, dëgjimi, perceptimi i ngjyrave);
- analizat e gjakut ose të urinës, testimi ndër të tjera për diabetin *Mellitus*, për aq sa janë të nevojshme për të gjykuar aftësitë fizike të kandidatit;
- një elektrokardiogram (EKG);
- teste për substanca psikotrope, si droga të paligjshme ose ilaçe psikotrope dhe abuzimi me alkoolin që vë në pikëpyetje aftësinë për këtë punë;
- njohëse: vëmendja dhe përqendrimi; kujtesa; perceptimi; arsyetimi;
- komunikimi;
- psikomotorike: koha e reagimit, koordinimi i duarve.

2.2 Kontrollat psikologjike profesionale

Qëllimi i kontrolleve psikologjike profesionale është të ndihmojë në emërimin dhe menaxhimin e stafit. Në përcaktimin e përmbajtjes së vlerësimit psikologjik, ekzaminimi duhet të vlerësojë se makinisti kërkues nuk ka mangësi të vërtetuara psikologjike profesionale, veçanërisht në aftësitë operative ose ndonjë faktor përkatës të personalitetit, që ka të ngjarë të ndërhyjë në ushtrimin e sigurt të detyrave.

3. KONTROLLET PERIODIKE PAS PAJISJES ME LICENCË APO CERTIFIKATË

3.1 Frekuenca

Kontrollet mjekësore kryhen të paktën çdo tre vjet deri në moshën 55 vjeç, e më pas çdo vit.

Përveç kësaj frekuence, mjeku i akredituar ose i njohur sipas nenit 26, bën kontrolle, nëse:

- ka arsye për të dyshuar se një mbajtës i licencës ose certifikatës nuk i plotëson më kërkesat mjekësore të mësipërme;
- pas çdo aksidenti në punë;
- pas çdo periudhe mungese prej të paktën 30 ditësh.

3.2 Përmbajtja minimale e kontrollit mjekësor periodik

Nëse makinisti përmbush kriteret e kërkuara për kontrollin që kryhet përpara pajisjes me licencë apo certifikatë, kontrollet periodike përfshijnë minimalisht:

- një kontroll të përgjithshëm mjekësor;
- një kontroll të funksioneve shqisore (shikimi, dëgjimi, perceptimi i ngjyrave);
- testet e gjakut ose të urinës për të zbuluar diabetin mellitus dhe gjendje të tjera, siç tregohet nga ekzaminimi klinik;
- testet për substanca psikotrope, si droga të paligjshme ose ilaçe psikotrope dhe abuzimi me alkoolin që vë në pikëpyetje aftësinë për këtë punë.

Përveç kësaj, një EKG kërkohet, gjithashtu, për drejtuesit e trenave mbi 40 vjeç.

ANEKSI III METODA E TRAJNIMIT

Trajnimi teorik (klasë dhe demonstrime) është në proporcion të drejtë me trajnimin praktik (drejtim treni me mbikëqyrje dhe pa mbikëqyrje në linja hekurudhore të cilat janë të mbyllura për qëllime trajnimi).

Trajnimi me kompjuter pranohet për mësimin individual të rregullave operacionale, situatave të sinjalizimit etj.

Përdorimi i simulatorëve, edhe pse jo i detyrueshëm, është i dobishëm për trajnimin efektiv të makinistëve; ato janë veçanërisht të dobishme për trajnime në kushte jonormale të punës ose për rregulla që zbatohen rrallë.

Për sa i përket përvetësimit të njohurive për infrastrukturën, makinisti shoqëron një makinist tjetër për një numër të përshtatshëm udhëtimesh përgjatë itinerarit, si ditën ashtu edhe gjatë natës.

Si një metodë alternative e trajnimit përdoren ndër metodat e tjera dhe videot e infrastrukturës ashtu si shihen nga kabina e makinistit.

ANEKSI IV NJOHURI DHE KËRKESA TË PËRGJITHSHME PROFESIONALE LIDHUR ME LICENCËN

Trajnimi i përgjithshëm ka këta objektiva:

- Përvetësimi i njohurive dhe procedurave në lidhje me terminologjitë hekurudhore, duke përfshirë parimet e sigurisë dhe rregulloret e funksionimit të transportit hekurudhor;

- Marrjen e njohurive dhe procedurave, në lidhje me rreziqet që lidhen me funksionimin hekurudhor dhe mjetet e ndryshme për evitimin e tyre;

- Marrjen e njohurive dhe procedurave në lidhje me parimet që drejtojnë një ose më shumë mënyra funksionimi hekurudhor;

- Marrjen e njohurive dhe procedurave në lidhje me trenat, përbërjen e tyre dhe kërkesat teknike për njësitë tërheqëse, vagonët dhe mjetet e tjera lëvizëse.

Në veçanti, makinistët:

- Kuptojnë kërkesat specifike që duhen për të punuar në profesionin e makinistit, rëndësinë e tij dhe kërkesat profesionale dhe personale (periudha të gjata të punës, të qenit larg shtëpisë etj.);

- Zbatojnë rregullat e sigurisë së personelit;

- Identifikojnë mjetet hekurudhore;

- Njohin dhe zbatojnë një metodë pune në mënyrë të saktë;

- Njohin manualin e procedurave hekurudhore, manualin e linjave, manualin e makinistit, të avarive etj.;

- Mësojnë sjellje që janë në përputhje me përgjegjësitë kritike për sigurinë;

- Identifikojnë procedurat e zbatueshme për aksidentet që përfshijnë persona;

- Dallojnë rreziqet e përfshira në operacionet hekurudhore në përgjithësi;

- Njohin parimet që rregullojnë sigurinë në trafik;

-Zbatojnë parimet bazë të elektroteknologjisë.

ANEKSI V NJOHURI PROFESIONALE TË MJETEVE KOHA DHE KËRKESAT LIDHUR ME CERTIFIKATËN

Pas përfundimit të trajnimit specifik në lidhje me mjetet hekurudhore, makinistët kryejnë detyrat e mëposhtme:

1. KONTROLLET PARA NISJES

Makinistët marrin njohuri në mënyrë që të:

- mbajnë dokumentacionin dhe pajisjet e nevojshme;
- kontrollojnë aparaturat e lokomotivës;
- kontrollojnë informacionin e futur në dokumentet në bordin e lokomotivës;
- sigurojnë, duke kryer kontrollet dhe testet e specifikuara, që lokomotiva është e aftë të sigurojë fuqinë e kërkuar tërheqëse dhe që pajisjet e sigurisë janë në funksion;
- kontrollojnë disponueshmërinë dhe funksionalitetin e pajisjeve mbrojtëse dhe të sigurisë në dorëzimin e një lokomotive ose në fillim të një udhëtimi;
- kryejnë çdo operacion rutinë të mirëmbajtjes parandaluese.

2. NJOHURI PËR MJETET HEKURUDHORE

Për të përdorur një lokomotivë, makinistët kontrollojnë treguesit që kanë të bëjnë, me:

- tërheqjen;
- frenimin;
- elemente që lidhen me sigurinë e trafikut.

Për të zbuluar dhe lokalizuar anomalitë në mjetet hekurudhore, për t'i raportuar ato dhe për të përcaktuar se çfarë kërkohet për t'i riparuar ato, dhe në raste të caktuara, për të ndërmarrë veprime, makinistët njihen, me:

- strukturat mekanike;
- pajisjet e suspensionit dhe lidhjes;
- pajisjet e sistemit të ecjes;
- pajisjet e sigurisë;
- rezervuarët e karburantit, sistemi i furnizimit me karburant dhe i shkarkimit të gazrave;
- kuptimi i shenjave në pjesën e brendshme dhe të jashtme të mjeteve hekurudhore, veçanërisht simbolet e përdorura për transportin e mallrave të rrezikshme;
- sistemet e regjistrimit të udhëtimeve;
- sistemet elektrike dhe pneumatike;
- sistemet elektrike dhe të tensionit të lartë;
- pajisjet e komunikimit (radio nga toka në tren etj.);
- organizimet e udhëtimeve;
- pjesët përbërëse të mjeteve hekurudhore, qëllimi i tyre dhe pajisjet specifike për mjetet hekurudhore të tërhequra, në veçanti sistemi i ndalimit të trenit;
- sistemi i frenimit;
- pjesët specifike për njësitë tërheqëse;
- motorët dhe transmisioni.

3. TESTIMI I FRENAVE

Makinistët marrin njohuri në mënyrë që të:

- kontrollojnë dhe llogarisin, përpara nisjes, që fuqia e frenimit të trenit korrespondon me fuqinë e frenimit të kërkuar për linjën, siç specifikohet në dokumentet e mjetit;
- kontrollojnë funksionimin e komponentëve të ndryshëm të sistemit të frenimit të njësisë tërheqëse dhe të trenit, sipas rastit, përpara nisjes, në nisje dhe gjatë lëvizjes.

4. MËNYRA E FUNKSIONIMIT DHE SHPEJTËSIA MAKSIMALE E TRENIT NË LIDHJE ME KARAKTERISTIKAT E LINJËS

Makinistët marrin njohuri në mënyrë që të:

- zbatojnë informacionin që u është dhënë përpara nisjes;

- të përcaktojë llojin e lëvizjes dhe shpejtësinë kufitare të trenit në bazë të variablave si kufijtë e shpejtësisë, kushtet e motit ose çdo ndryshim sinjalizimi.

5. DREJTIMI I TRENIT NË MËNYRË QË NUK DËMTON INSTALIMET APO PAJISJET

Makinistët marrin njohuri, në mënyrë që të:

- përdorin të gjitha sistemet e disponueshme të kontrollit, në përputhje me rregullat në fuqi;
- nisin trenin duke marrë parasysh kufizimet e fuqisë;
- përdorin frenat për ngadalësimet dhe ndalesat, duke marrë parasysh mjetet hekurudhore.

6. ANOMALITË

Makinistët marrin njohuri, në mënyrë që:

- të jenë të vëmendshëm ndaj dukurive të pazakonta në lidhje me lëvizjen e trenit;
- të jenë në gjendje të inspektojnë trenin dhe të identifikojnë shenjat e anomalive, të bëjnë dallimin midis tyre, të reagojnë sipas rëndësisë së tyre relative dhe të përpiqen t'i korrigojnë ato, duke i dhënë gjithmonë përparësi sigurisë së trafikut hekurudhor dhe personave;
- të njohin mjetet e disponueshme të mbrojtjes dhe komunikimit.

7. VEPRIMET NË RAST INCIDENTESH, AKSIDENTESH DHE RËNIE ZJARRI

Makinistët marrin njohuri në mënyrë që të:

- jenë në gjendje të marrin masa për të mbrojtur trenin dhe të kërkojnë ndihmë në rast të një aksidenti ku përfshihen persona në bordin e trenit;
- jenë në gjendje të përcaktojnë nëse treni po transporton mallra të rrezikshme dhe t'i identifikojë ato në bazë të dokumenteve të trenit dhe listave të vagonëve;
- njohin procedurat në lidhje me evakuimin e një treni në rast emergjence.

8. KUSHTET PËR VAZHDIMIN E FUNKSIONIMIT PAS NJË INCIDENTI QË PËRFSHIN MJETET HEKURUDHORE

Pas një incidenti, makinistët vlerësojnë nëse mjeti mund të vazhdojë të lëvizë dhe në çfarë kushtesh, në mënyrë që të informojë administratorin e infrastrukturës për ato kushte, sa më shpejt të jetë e mundur.

Makinistët përcaktojnë nëse është i nevojshëm një vlerësim nga ekspertët përpara se treni të vazhdojë lëvizjen.

9. SIGURIMI I TRENIT PAS NDALESËS

Makinistët marrin masa për sigurimin e trenit ose pjesë të tij, që të mos ndizet ose të lëvizë papritur, edhe në kushtet më të vështira.

Për më tepër, makinistët nëpërmjet njohurive praktike të marra, ndalojnë një tren ose pjesë të tij në rast se ai ka filluar të lëvizë papritur.

ANEKSI VI

NJOHURI PROFESIONALE TË INFRASTRUKTURËS DHE KËRKESAT LIDHUR ME CERTIFIKATËN

Çështjet që kanë të bëjnë me infrastrukturën

1. TESTIMI I FRENAVE

Makinistët kontrollojnë përpara nisjes fuqinë frenuese të trenit, e cila korrespondon me fuqinë e frenimit të kërkuar për linjën, siç specifikohet në dokumentet e mjetit.

2. LLOJI I FUNKSIONIMIT DHE SHPEJTËSIA MAKSIMALE E TRENIT SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË LINJËS

Makinistët para nisjes:

- marrin parasysh informacionin që u jepet, si kufijtë e shpejtësisë ose çdo ndryshim sinjalizimi;
- përcaktojnë llojin e lëvizjes dhe shpejtësinë kufitare të trenit në bazë të karakteristikave të linjës.

3. NJOHURI PËR LINJËN

Makinistët kanë njohuri të plotë për linjat dhe instalimet hekurudhore në itinerarin e tyre dhe për çdo rrugë alternative për të cilën është rënë dakord. Mbi këtë njohje parashikojnë problemet

dhe reagimet që duhen për sa i përket sigurisë dhe performancave të tjera, si përpikëria dhe aspektet ekonomike.

Aspektet e mëposhtme janë të rëndësishme:

- kushtet e funksionimit (ndryshimet e itinerarit, qarkullimi në një drejtim etj.);
- kontrolli i infrastrukturës dhe pajisja me dokumentet përkatëse;
- rregullat e zbatueshme të trafikut dhe kuptimin e sistemit të sinjalizimit;
- regjimi i operacioneve;
- rregulloret përkatëse për nisjen, udhëtimin dhe ndalimin;
- emrat e stacioneve dhe pozicionin, dhe shikimi në distancë i stacioneve dhe kutive të sinjalit për të përshtatur drejtimin, në përputhje me rrethanat;
- sinjalizimi i tranzicionit midis sistemeve të ndryshme të funksionimit ose furnizimit me energji elektrike;
- kufijtë e shpejtësisë për kategoritë e ndryshme të trenave të drejtuara;
- profilet topografike;
- kushte të veçanta frenimi, për shembull në linja me një pjerrësi apo ngjitje;
- karakteristika të veçanta të funksionimit: sinjale të veçanta, shenja, kushtet e nisjes etj.

4. RREGULLAT E SIGURISË

Makinistët marrin njohuri në mënyrë që të:

- nisin trenin vetëm, kur plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara (orari, sinjali i nisjes, funksionimi i sinjaleve nëse kërkohet etj.);
- kontrollojnë aparataturat në kabinë dhe veprojnë siç specifikohet;
- drejtojnë trenin në mënyrë të sigurt sipas mënyrave specifike të funksionimit: veprojnë me mënyra të veçanta, nëse udhëzohet, kufizime të përkohshme të shpejtësisë, lëvizje në drejtim të kundërt, leje për të kaluar sinjale në rrezik, operacione ndërrimi, kthesa, kalim nëpër kantiere etj.;
- respektojnë ndalesat e planifikuara ose suplementare, dhe nëse është e nevojshme kryejnë operacione shtesë për pasagjerët gjatë këtyre ndalesave, veçanërisht hapjen dhe mbylljen e dyerve.

5. DREJTIMI I TRENIT

Makinistët marrin njohuri në mënyrë që të:

- gjithmonë dinë pozicionin e trenit në linjë;
- përdorin frenat për ngadalësimet dhe ndalesat;
- rregullojnë ecurinë e trenit, në përputhje me orarin dhe çdo urdhër të dhënë për kursimin e energjisë, duke marrë parasysh karakteristikat e lokomotivës, trenit, linjës dhe mjedisit.

6. ANOMALITË

Makinistët marrin njohuri, në mënyrë që të:

- janë të vëmendshëm, për aq sa e lejon funksionimi i trenit, ndaj dukurive të pazakonta në lidhje me infrastrukturën dhe mjedisin: sinjalet, shinat, furnizimi me energji, kalimet në nivel, rrethimi i binarëve, trafiku tjetër;
- mbajnë distanca të nevojshme në mënyrë që të largohen pengesat;
- informojnë administratorin e infrastrukturës sa më shpejt të jetë e mundur për vendin dhe natyrën e anomalive të vërejtura, duke u siguruar që informacioni të jetë kuptuar;
- duke marrë parasysh infrastrukturën, sigurojnë ose marrin masa për të garantuar sigurinë e trafikut dhe të personave, sa herë që është e nevojshme.

7. VEPRIMET NË RAST INCIDENTESH, AKSIDENTESH DHE RËNIE ZJARRI

Makinistët marrin njohuri në mënyrë që të:

- marrin masa të mbrojnë trenin dhe kërkojnë ndihmë në rast të një aksidenti ku përfshihen persona;
- përcaktojnë vendin ku të ndalojnë trenin në rast zjarri dhe mundësojnë evakuimin e pasagjerëve, nëse është e nevojshme;
- japin informacion të dobishëm për zjarrin sa më shpejt të jetë e mundur nëse zjarri nuk mund të vihet nën kontroll nga makinisti që vepron i vetëm;
- informojnë administratorin e infrastrukturës për këto kushte sa më shpejt të jetë e mundur;
- vlerësojnë nëse infrastruktura lejon që treni të vazhdojë të funksionojë dhe në cilat kushte.

8. TESTET E GJUHËS

Makinistët që komunikojnë me administratorin e infrastrukturës për çështje të sigurisë duhet të kenë aftësi gjuhësore në gjuhën e administratorit të infrastrukturës në fjalë, në nivelin që të mund të komunikojnë në mënyrë aktive dhe efektive në situata rutinë, të pafavorshme dhe emergjente.

Makinistët përdorin mesazhet dhe metodën e komunikimit të specifikuar në TSI dhe zotërojnë nivelin 3 të tabelës së mëposhtme:

Niveli	Përshkrim
5	<ul style="list-style-type: none"> - mund të përshtatë mënyrën e të folurit me cilindo bashkëbisedues - mund të paraqesë një mendim - mund të negociojë - mund të bindë - mund të japë këshilla
4	<ul style="list-style-type: none"> - mund të përballojë situata krejtësisht të paparashikuara - mund të bëjë supozime - mund të shprehë një mendim të argumentuar
3	<ul style="list-style-type: none"> - mund të përballojë situata praktike që përfshijnë një element të paparashikuar - mund të përshkruajë - mund të vazhdojë një bisedë e thjeshtë
2	<ul style="list-style-type: none"> - mund të përballojë situata të thjeshta praktike - mund të bëjë pyetje - mund t'u përgjigjet pyetjeve
1	<ul style="list-style-type: none"> - mund të flasë duke përdorur fjali të mësuara përmendësh

ANEKSI VII FREKUENCA E PROVIMEVE

Frekuenca minimale e kontrolleve periodike do të jetë, si më poshtë:

a) njohuri gjuhësore: çdo tre vjet (për makinistët që nuk janë shqiptarë) ose pas çdo mungese më shumë se një vit;

b) njohuri për infrastrukturën (përfshirë njohuritë për rregullat e infrastrukturës dhe qarkullimit): çdo tre vjet ose pas çdo mungese më shumë se një viti në itinerarin përkatës;

c) njohuri për mjetet hekurudhore: çdo tre vjet.

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në udhëzimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 24, datë 13.12.2022, “Për formimin profesional në qendrat e formimit profesional të personelit hekurudhor që ushtron funksione sigurie, kushtet dhe procedurat për testimin, licencimin dhe certifikimin e makinistëve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 174, datë 23.12.2022

bëhet korrigjimi si më poshtë:

“Në neni 8

Kërkesa për njohjen, rinovimin ose ndryshimin e një qendre formimi profesional

Të shtohet pika 5

5. Rregullat dhe procedurat për krijimin e Qendrave të Formimit Profesional nga administruesit e infrastrukturës dhe sipërmarrjet hekurudhore private miratohen me urdhër ministri.”.